

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI: AGROEKONOMI
PROGRAMI: EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema me titull:

Dallimet në rendiment dhe në kosto të prodhimit në mes të varieteteve të Rrushit Muskat Itali dhe Viktoria në kushte të njëjta të kultivimit

Udhëheqësi shkencor:

Prof. Dr. Arben Musliu

Kandidati:

Bsc. Veton Mustafa

Qershor, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI: AGROEKONOMI
PROGRAMI: EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema me titull:

PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema me titull:

Dallimet në rendiment dhe në kosto të prodhimit në mes të varieteteve të Rrushit Muskat Itali dhe Viktoria në kushte të njëjta të kultivimit

Udhëheqësi shkencor:
Prof. Dr. Arben Musliu

Kandidati:
Bsc. Veton Mustafa

Qershor, 2023

DEKLARATË PËR PLAGJIATURË

NGA AUTORI I PUNIMIT TË MASTERIT

Unë Veton Mustafa, si student i nivelit Master në Departamentin e “Agroekonomisë”, programi i studimeve Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit, para mbrojtjes së punimit të masterit, nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim i Masterit me titull: **“Dallimet në rendiment dhe në kosto të prodhimit në mes të varieteteve të rrushit Muskat Itali dhe Viktoria në kushte të njëjta të kultivimit”** është punuar prej meje. Punimi nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë e veçantë e tij. Punimi në tërësi u përmbahet rregullave për plagjiaturë. Punimi, nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara. Andaj vetëm unë mbaj përgjegjësi personale deri në anulim të titullit të fituar në bazë të mbrojtjes së këtij punimi. Përgjegjësi për plagjiaturë në asnjë formë nuk mbajnë institucioni dhe anëtarët e komisionit.

Deklaratën e nënshkruaj në prezencë të personit zyrtarë.

Prishtinë, Datë: _____

Nënshkrimi i kandidatit: _____

Nënshkrimi i mentorit: _____

Falënderimet

Falënderimet më të sinqerta nga unë shkojnë për Zotin, nga i cili mora shëndet dhe motiv të studioj për gjatë këtyre dy viteve por edhe gjatë gjithë jetës sime. Mirënjohje e veçantë nga unë shkon për Universitetin e Prishtinës, profesorët me të cilët kam kaluar vite të jashtëzakonshme, mirënjohje të veçantë i shpreh mentorit tim Prof. Dr. Arben Musliu, i cili ka bërë një punë të palodhshme në zhvillimin tonë si profesionistë në lëmin e ekonomisë së bujqësisë dhe ushqimit! Mentorin tim e falënderoj edhe për kohën e kushtuar ndaj meje si mentor i punimit! Falënderoj nga zemra edhe familjen time e cila ka qenë shtylla kryesore e zhvillimit tim gjatë këtyre viteve të studimit, mbeshtetja e tyre, sakrifica për mua dhe ndihma ndaj meje kanë qenë motiv për mua për të përfunduar studimet në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur! I falënderoj përzemërsisht të gjithë ata që në çfarëdo mënyre kanë kontribuar që unë sot të përfundoj studimet e nivelit Master!

Me respekt:

Bsc. Veton Mustafa

Dedikim

Familjes sime

Përmbajtja

Falënderimet.....	6
Lista e figurave.....	10
Lista e tabelave.....	11
Abstrakti.....	12
Abstract.....	13
KAPITULLI 1.....	14
1. HYRJE.....	14
1.1. Identifikimi i problemit.....	14
1.2. Arsyeshmeria e temës - Problemi i hulumtimit.....	16
KAPITULLI 2.....	20
2. RISHIKIMI I LITERATURËS.....	20
2.1. Historiku i vreshtarisë.....	20
2.2. Kostoja e prodhimit dhe profitabiliteti.....	24
2.3. Metoda e prodhimit ekonomikisht eficient.....	24
2.3.1. Efikasiteti teknik në prodhim.....	25
2.3.2. Ekonomia e shkallës.....	25
2.3.3. Disekonomitë e shkallës.....	25
2.4. Profitabiliteti.....	25
2.5. Eficienca alokative.....	25
2.6. Pika e mbulimit apo pragu i rendimentit.....	26
2.7. Gjendja e faktorëve ekonomik dhe social që ndikojnë në kosto të prodhimit.....	26
2.7.1. Çmimi.....	26
2.7.2. Kreditë për Bujqësi.....	27
2.7.3. Punësimi.....	28
2.8. Eksporti dhe importi i rrushit.....	29
2.9. Eksporti dhe importi në vendet e tjera në botë.....	33
2.10. Faktorët ekologjik që ndikojnë në kultivimin e hardhisë së rrushit.....	35
2.10.1. Karakteristikat klimatike.....	35
2.10.2. Temperatura e ajrit.....	36
2.10.3. Reshjet e shiut.....	38
2.10.4. Lagështia relative e ajrit.....	39
2.10.5. Rrezatimi diellor.....	39

2.11. Toka	40
2.12. Sëmundjet dhe dëmtuesit	41
2.13. Faktorët institucional - Subvencionet	42
2.14. Masat e zhvillimit rural në Kosovë	43
KAPITULLI 3.....	46
3. METODOLOGJIA DHE METODAT.....	46
3.1 Metodologjia dhe Metodat e aplikuara	46
KAPITULLI 4.....	47
4. REZULTATET DHE DISKUTIMI.....	47
4.1. Hyrje ne kapitullin e rezultateve	47
4.2. Raporti në mes varitetit të rrushit dhe numrit të hektarëve	48
4.3. Varieteti i rrushit dhe numri i hektarëve të fermerëve	49
4.4. Varieteti i rrushit dhe Kthimi në investim	50
4.5. Varietetet e rrushit dhe kostoja e prodhimit.....	53
KAPITULLI 5.....	57
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	57
5.1 Konkluzionet e studimit.....	57
5.2. Tri perfundimet e studimit.....	57
5.3. Rekomandimet.....	60
KAPITULLI 6.....	63
Literatura e përdorur:.....	66

Lista e figurave

Figure 1. Rajonet vreshtare të Kosovës.....	21
Figure 2. Ndarja e varieteteve të rrushit sipas destinimit të prodhimit.....	22
Figure 3. Struktura e vreshtave në Kosovë.....	22
Figure 4. Varieteti i rrushit - Muskat Italia.....	23
Figure 5. Varieteti i rrushit – Victoria.....	23
Figure 6. Eksporti i rrushit të tryezës 2015-2016, në ton (majtas) dhe në ‘000 € (djathtas).....	29
Figure 7. Eksporti i rrushit për verë 2015-2016, në ton (majtas) dhe në ‘000 € (djathtas).....	30
Figure 8. Eksporti i rrushit të tryezës (majtas) dhe rrushit për verë (djathtas) sipas shteteve në vitin 2016.....	30
Figure 9. Importi i rrushit të tryezës 2015-2016, në ton (majtas) dhe në ‘000 € (djathtas).....	31
Figure 10. Importi i rrushit për verë 2015-2016, në ton (majtas) dhe në ‘000 € (djathtas).....	31
Figure 11. Importi i rrushit të tryezës (majtas) dhe rrushit për verë (djathtas) sipas shteteve në vitin 2016.....	32
Figure 12. Bilanci tregtar për rrush 2015-2016 në ‘000 €.....	32
Figure 13. Eksporti i rrushit 2014-2015, (vendet që eksportojnë më së shumti), në ton.....	33
Figure 14. Importi i rrushit 2014-2015, (vendet që importojnë më së shumti), në ton.....	34
Figure 15. Çmimet e rrushit të tryezës në vitin 2015, €/kg.....	34
Figure 16. Çmimet e rrushit të verës në vitin 2015, €/kg.....	35
Figure 17. Pagesat direkte për fermerët me hardhi rrushi për gjatë viteve 2012-2016.....	43
Figure 18. Varieteti i rrushit dhe numri i hektarëve të fermerëve, pjesë e hulumtimit tonë.....	49
Figure 19. Varieteti i rrushit dhe kthemi në investime, pjesë e hulumtimit tonë.....	52
Figure 20. Varieteti i rrushit dhe kosto e prodhimit, pjesë e hulumtimit tonë.....	55

Lista e tabelave

Table 1. Mesatarja mujore, mesatarja maksimale, mesatarja minimale dhe vjetore e temperaturave të ajrit 2012/18.....	36
Table 2. Reshjet mesatare në Rahovec për gjatë viteve 2012-2018.....	38
Table 3. Lagështia relative të ajrit në Rahovec për gjatë viteve 2012-2018.....	39
Table 4. Kohëzgjatja e rrezatimit diellor në orë për periudhën 2012/18.....	40
Table 5. Raporti i Varietetit të rrushit dhe numri i hektarëve – Crosstabulation.....	48
Table 6. Raporti i Varietetit të rrushit dhe numri i hektarëve - Chi-Square Tests.....	49
Table 7. Varieteti i rrushit * Kthimi në investim - Crosstabulation.....	51
Table 8. Varieteti i rrushit * Kthimi në investim - Chi-Square Tests.....	51
Table 9. Varieteti i rrushit * Kosto e prodhimit - Crosstabulation.....	54
Table 10. Varieteti i rrushit * Kosto e prodhimit - Chi-Square Tests.....	55

Abstrakti

Hardhia e rrushit është një prej kulturave bujqësore mjaft të njohura në Kosovë. Kjo argumentohet edhe sa i përketë prodhimit të rrushit në Kosovë njëashtu tregohet edhe sa i përketë industrisë së ndërlidhur të veres. Në këtë studim janë analizuar diferencat në aspektin ekonomik në mes dy kultivarëve të njohur: Muskatit Italian dhe Viktorias.

Hulumtimi është zhvilluar në shtetin e Kosoves, me fermerë vreshtar që kultivojnë njërin prej dy llojeve të hardhisë së rrushit. Intervistimi i fermerëve është bërë në mënyrë të drejtëpërdrejtë me anë të pyetësorit, ku madhësia e mostrës përbehet prej 31 intervista me fermer vreshtar. Të dhënat janë marrë dhe përpunuar me programet softuerike Excel dhe SPSS.

Rezultatet e studimit tregojnë se lidhshmëria ndërmjet varietetit të rrushit dhe numrit të hektarëve të mbjella me rrush nuk është statistikisht signifikante. Studimi në qendër poashtu ka hulumtuar edhe lidhshmërinë në mes kultivarit dhe koston e prodhimit dhe ka analizuar edhe raportin në mes të dy kultivarëve të rrushit me kthimin në investim.

Studimet e bëra nga autori ndihmojnë në identifikimin e varieteteve të rrushit që kanë më shumë kërkesë në treg dhe ndihmojnë fermerët të zgjedhin llojin e rrushit që ata do të duan të kultivojnë në të ardhmen. Poashtu ky studim mund të ndihmojë fermerët në marrjen e vendimeve më të mira në lidhje me caktimin e hektarëve për secilin lloj të varietetit të rrushit dhe të ndihmojë në optimizimin e prodhimit të tyre.

Fjalët kyçe: rendimenti, kosto e prodhimit, kthim në investim, muskat, viktorija.

Abstract

The grape vine is one of the most popular agricultural crops in Kosovo. This is argued with regard to the production of grapes in Kosovo, as well as shown with regard to the related wine industry. In this study, the differences in the economic aspect between two well-known cultivars: Italian Muskat and Victoria were analyzed.

The research was conducted in the state of Kosovo, with viticultural farmers who cultivate one of two types of grape vines. The interviewing of farmers was done directly by means of the questionnaire, where the sample size consists of 31 interviews with viticultural farmers. Data were obtained and processed with Excel and SPSS software programs.

The results of the study show that the relationship between the grape variety and the number of hectares planted with grapes is not statistically significant. The study at the center also investigated the relationship between the cultivar and the cost of production and analyzed the relationship between the two grape cultivars and the return on investment.

The studies done by the author help to identify the grape varieties that have the most demand in the market and help the farmers to choose the type of grapes that they will want to grow in the future. Also, this study can help farmers in making better decisions regarding the allocation of hectares for each type of grape variety and help optimize their production.

Key words: yield, cost of production, return on investment, muskat, victoria.

KAPITULLI 1

1. HYRJE

1.1. Identifikimi i problemit

Vreshtaria në Kosovë paraqet potencial të madh ekonomik për vendin. Për shkak të pozitës gjeografike dhe kushteve të përshtatshme klimatike, Kosova ka traditë mijëra vjeçare në kultivimin e kulturës së rrushit të tryezës si dhe atij të verës. Ky sektor ishte shumë i zhvilluar deri në vitet e '90-ta deri kur filloi politika diskriminuese serbe. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, pati mjaft ngecje në zhvillim të industrisë së verës për shkak të statusit të pa definuar të vendit dhe procesit të ngadalshëm të privatizimit. Një pjesë e madhe e tokave të destinuara për kultivim të vreshtave punoheshin pak ose mbetën djerrinë. Nga viti 2006, me privatizimin e disa ndërmarrjeve si dhe me përkrahjen dhe përkushtimin e madh të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, industria e verës filloi të zhvillohej përsëri. Sot, vreshtaria dhe prodhimi i verës është një ndër sektorët më strategjik për Kosovën, dhe jo vetëm që plotëson nevojat e brendshme, por arrin që të eksportohet me sukses edhe në tregjet e rajonit dhe anë e mbanë botës. Me përkrahjen e Ministrisë së Bujqësisë nëpërmes subvencioneve, është shtuar dukshëm sipërfaqja e kultivuar me vreshta, e kjo përveç që ka ndikuar në zhvillim ekonomik, po ashtu ka pasur ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin e turizmit kulturor dhe agro-turizmit. Qëllimi i kësaj analize është të paraqes gjendjen e viteve të fundit të sektorit të vreshtarisë dhe prodhimit të verës në Kosovë si dhe ta krahasojë me tregun botëror. Në këtë analizë janë paraqitur të dhëna lidhur me sipërfaqen, prodhimin, rendimentin, tregtinë dhe çmimet e rrushit dhe verës në Kosovë dhe vende tjera të cilat janë marrë nga burime të ndryshme kredibile dhe të cilat janë përpunuar nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore. Ky departament është përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave ekonomiko-statistikore të cilat e ndihmojnë MBPZHR-në që të hartojë raporte dhe analiza të detajuara mbi bazën e të cilave hartohen politikat e mirëfillta bujqësore sipas situatës aktuale (MBPZHR, 2021).

Në shumë sektorë ekonomik, prodhuesit duhet të numërojnë një numër të burimeve të riskut dhe pasigurisë në procesin e marrjes së vendimeve. Sektori i bujqësisë nuk ka përjashtim, risku dhe pasiguria janë komponentët kyç në marrjen e vendimeve (Lota D. Tamini, Maurice Doyon, Micheline M.Zan, 2014). Sektori i bujqësisë është një biznes tërheqës i cili siguron të ardhura të

mëdha gjatë gjithë vitit dhe gjeneron kthim të shpejtë dhe të vazhdueshëm të investimit (Olumide).

Vreshtaria si sektor në Kosovë ka qenë e zhvilluar qysh para 2000 viteve. Kushtet e mira klimatike si një nga faktorët kryesor që përcaktojnë prodhimin janë në favor të zhvillimit të këtij sektori. Duke marrë parasysh resurset natyrore, numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar dhe rëndësinë në zhvillimin e sektorit të verërave dhe agro-përpunimit, sektori vreshtarisë shihet si sektor me rëndësi ekonomike për vendin. Në bazë të ligjit për verëra Kosova është e ndarë në dy rajone të vreshtarisë, atë të Dukagjinit dhe të Rrafshit të Kosovës dhe pastaj rajonet janë të ndara në nën rajone (veri dhe jug).

Vlerat ushqyese të rrushit janë shumë të larta, sipas (Dr. Aliebstein) “ rrushi është ushqim ideal për secilin prej nesh” ky frutë i çmuar, përveç vlerave të larta ushqyese, ka edhe vlera të larta kuruese. Është e rëndësishme të theksohet se pjesën më të ushqyeshme, rrushi e ka të lëkura e tij. Rrushi përmban vitamina (A, B₁,B₂,B₆,C) dhe minerale (kalcium fosfor, hekur dhe magnezium),

Mjekësia bashkëkohore ka vërtetuar këto veti shëruese të rrushit:

- ✓ Pastron gjakun dhe organizmin në përgjithësi;
- ✓ Forcon mëlçinë , personat që vuajnë nga gastriti u këshillohet ta përdorin tri herë në ditë nga 200 deri në 300gr një ose dy orë para bukës;
- ✓ Është ilaç efikas kundër hemorroideve;
- ✓ Këshillohet të përdoret për nxjerrjen e gurëve nga veshkat. Rezultatet e dëshiruara mund të arrihen nëse konsumohet 300gr rrush para ushqimit për 20 ditë rresht;
- ✓ Për sëmundjet e lëkurës dhe për freskimin e saj, rrushi përdoret duke e kombinuar me vitamina.

Në periudhën e paraluftës, sipërfaqet e kultivuara me vreshta kanë qenë shumë më të mëdha sesa që janë sot. Në vitin 1988 sipërfaqja me vreshta në Kosove ka qenë rreth 9,000 ha, ndërsa sot në Kosovë kultivohen 3,117 ha, prej të cilave 769 ha janë me rrush tryeze dhe 2,348 ha me rrush për verë. Ngastrat e vreshtave kryesisht janë të vogla me një mesatare prej 0.50ha, e duke marrë parasysh këtë fakt si dhe atë se vreshtat janë të vjetra si dhe mekanizmi i vjetruar, kosto e prodhimit të rrushit është e lartë. Pjesa më e madhe, rreth 75% e vreshtave janë në pronësi të

fermerëve ndërsa pjesa tjetër rreth 25% është në pronësi të kompanive prodhuese të verës. Mbështetja përmes pagesave direkte ndikon drejtpërdrejt në uljen e kostos së prodhimit, ndërsa përmes masave të zhvillimit rural mbështeten investimet në infrastrukturë dhe makineri në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të rrushit.

Në vitin 2014 sipërfaqja totale me vreshta llogaritet të jetë rreth 7.9mil. ha apo 1% më e madhe sesa në vitin 2013. Në periudhën 2010-2014, nëse analizojmë mesataren e sipërfaqes së kultivuar me vreshta, 5 vendet të cilat prijnë me sipërfaqen më të madhe të kultivuar janë: Spanja, Franca, Italia, Kina dhe Kina Kontinentale. Nga vendet e paraqitura në figurën e më poshtme, në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013, rritje të sipërfaqes së kultivuar kishin: Kina, Kina Kontinentale, Moldavia, Kili, Argjentina dhe India, ndërsa rënie në sipërfaqen e kultivuar kishte në këto vende: Australi, Iran, Itali, Spanjë, SHBA, Rumani, Francë, Turqi dhe Portugali.

Në periudhën 2010-2016, sipërfaqja mesatare e kultivuar me vreshta në Kosovë ishte 3,152 ha. Në vitin 2016 sipërfaqja me vreshta ishte 3,117 ha, 75% e së cilës ishte e kultivuar me rrush për verë dhe 25% me rrush tryeze. Në krahasim me vitin 2015, sipërfaqja me vreshta në vitin 2016 është rritur për 1.6%. Rritje më të madhe në përqindje në vitin 2016 ka pasur sipërfaqja e kultivuar me rrush tryeze, përkatësisht është rritur për 3%, ndërsa sipërfaqja me rrush për verë 1%. Në vitin 2016 sipërfaqja me rrush tryeze është rritur për 22 ha, ndërsa ajo me rrush verë për 27 ha.

Sa i përket varieteteve të rrushit të tryezës të kultivuara në vitin 2016, 33% e sipërfaqes së kultivuar me rrush tryeze është me Muskat Hamburg, 23% me Muskat Italian, 16% me Afuz Ali, 11% me Kardinal dhe 17% me varietetet tjera që kultivohen në sipërfaqe më të vogël që janë: Moldavkë, Ribier, Demir Kapi, Antigona, Rrush tryeze eksperimental, Viktoria, Black Magic, Mbretëresha, Groqanka, Red Globe, Muskat Korrikut, Crimson Seedless, Michele Palieri dhe Rrush pa farë.

1.2. Arsyeshmeria e temës - Problemi i hulumtimit

Kosova është e njohur me kushte të përshtatshme gjeografike dhe me klimë të mesme kontinentale në zhvillimin e sektorit të bujqësisë, e sidomos sektorit vreshtarisë. Sipas të dhënave historike, vendi ynë ishte i njohur për kultivimin e hardhisë së rrushit që nga mesjeta. Në

periudha të ndryshme kohore ky sektor ka pasur ngritje dhe rënieje drastike të sipërfaqeve me vreshta. Gjatë viteve 80-ta në Kosovë ishin rreth 9795 ha me vreshta, ndërsa pas viteve 90-ta këto sipërfaqe janë zvogëluar si rezultat i kushteve të rënda që mbretëronin në Kosovë dhe pas luftës së fundit në Kosovë kishin mbetur më pakë se 3000 ha me vreshta. Duke marr parasysh, rëndësin që ka ky sektor në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në shfrytëzimin racional të tokave bujqësore e sidomos të atyre tokave më pak të përshtatshme për kultura bujqësore, pas përfundimit të luftës, ka filluar ngritja e sipërfaqeve të reja me vreshta me kultivar të rrushit të tryezës. Gradualisht shumë fermer të komunës së Rahovecit me mundësi vetanake kanë ngritur plantacione me vreshta duke përmirësuar strukturën e varieteteve të rrushit të tryezës dhe duke ofruar rrush të kualitetit të lartë në tregun tonë Kosovar. Në zhvillimin e këtij sektori viteve të fundit ka ndikuar edhe mbështetja financiare nga ana e MBPZHR, në ngritjen e vreshtave të reja përmes granteve dhe subvencionimi i vreshtave ekzistues dhe sot sipas zyrës së kadastrave të vreshtave në Kosovë janë mbi 3068 ha me vreshta, nga kjo sipërfaqe, rreth 2314.47 ha, janë me rrush për verë apo 75.41% dhe 754.31 ha me rrush të tryezës apo 24.58 %.

Përmes përkrahjes nga ana e MBPZHR, për ngritjen e vreshtave të reja synohet që ky sektor të shtrihet edhe në zona të tjera si në ato të Pejës dhe Klinës, por ngritja e vreshtave të reja në këto dy zona është akoma e ulët.

Zona më e zhvilluar e vreshtarisë në Kosovë është ajo e Rahovecit dhe përfshin rreth 76% të vreshtave në vendin tonë, kjo dukuri është si rezultat i traditës së mirë që kanë vreshtarët e kësaj zone për kultivimin e hardhisë së rrushit dhe terrenit të përshtatshëm që disponon kjo zonë.

Madhësia e sipërfaqeve me vreshta është mjaft e ndryshme, duke filluar nga plantacionet me sipërfaqe mbi 100 ha që ishin pronë e ish ndërmarrjeve shoqërore të privatizuar NBI Rahoveci dhe NBI Suhareka. Fermerët individual posedojnë kryesisht plantacione me sipërfaqe mesatare nën 0.50 ha, e që është njeri nga faktorët që rrit koston e prodhimit të rrushit.

Meqë në vendin tonë janë më shumë sipërfaqe të mbjellura me rrush për verë, grumbullimi apo shitja e këtij rrushi behët në ndërmarrjet përpunuese të rrushit dhe një pjesë eksportohet në Shqipëri dhe në Mal të Zi, ndërsa rrushi i tryezës kryesisht shitet në vendin tonë dhe një sasi e vogël në vendet e BE-së. Kapaciteti prodhues për rrush tryeze në vendin tonë akoma është shumë

i ulët dhe plotëson vetëm 40% të nevojave për rrush të freskët, ndërsa pjesa tjetër vjen nga vendet fqinje apo rajonit.

Një ndër problemet që po e përcejell zhvillimin e sektorit të vreshtarisë në Kosovë është edhe politikat joadekuate për ngritjen e vreshtave të reja me rrush tryeze, struktura varietore e rrushit të tryezës, sistemet e ngritjes së vreshtave, mungesa e mundësisë për ujitjen e vreshtave, aplikimi i masave të reja agro dhe pomo-teknike për kultivim të rrushit të tryezës si dhe mundësia e ruajtjes së rrushit për një periudhë më të gjatë kohore. Duka pasur parasysh të gjitha këto faktor që i përmendëm, lind nevoja për një hulumtim/studim të mirëfilltë, këmbimin e përvojave profesionale me vendet të cilat janë më të avancuara për kultivim të rrushit të tryezës.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i studimit është që të bëj një analizë ekonomike të fermave prodhuese të rrushit të tryezës, përkatësisht të kultivarëve Muskat Itali dhe Viktoria, në rastet ku është e mundur, gjithashtu do të sigurohen të dhënat rreth investimeve dhe operacioneve financiare të lidhura me ngritjen e sipërfaqeve me rrush tryeze. Profitabiliteti i fermës do të përcaktohet duke përdorur tregues të kthimit të investimit duke përfshirë normën e kthimit të shpenzimeve operative (ROI) si dhe analizën e ndjeshmërisë.

Objektivi i përgjithshëm - Kostoja e prodhimit të rrushit të kultivarët Muskat Itali dhe Viktoria në kushte të ndryshme të kultivimit.

Objektivat specifike

- ✓ Të gjendet sa është rendimenti për njësi të sipërfaqes të kultivarëve Muskat Itali dhe Viktoria.
- ✓ Të gjendet sa është kostoja e prodhimit të rrushit të kultivarëve M.Itali dhe Viktoria.
- ✓ Të gjendet cili kultivar është me profitabil.
- ✓ Sa ndikon madhësia e sipërfaqes së vreshtit në uljen e kostos së prodhimit të rrushit.
- ✓ Të gjendet sa ndikon ujitja e vreshtave në rendiment dhe kualitet të rrushit.

- ✓ Të gjendet cili kultivar është me i përshtatshëm me fitim më të lartë.

Hipotezat e hulumtimit

Ky studim bazohet në ndikimin e kushteve të prodhimit të rrushit të kultivarëve M. Itali dhe Viktoria.

Hipoteza bazë - 0 është se kostoja e prodhimit të rrushit të kultivarëve Muskat itali dhe Viktoria nuk varet nga kultivaret e ndryshëm në kushtet e njejta të prodhimit.

Hipoteza alternative - 1 është se kostoja e prodhimit të rrushit të kultivarëve Muskat Itali dhe Viktoria varet nga kultivaret e ndryshëm në kushtet e njejta të prodhimit

KAPITULLI 2

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1. Historiku i vreshtarisë

Kultivimi i hardhisë se rrushit në Kosovë daton që nga koha e Ilireve. Vreshtaria si sektor në Kosovë ka qenë e zhvilluar qysh para 2000 vitëve. Kushtet e mira klimatike si një nga faktorët kryesor që përcaktojnë prodhimin janë në favor të zhvillimit të këtij sektori. Duke marr parasysh resurset natyrore, numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar dhe rëndësinë në zhvillimin e sektorit të verërave dhe agro-përpunimit, sektori i vreshtarisë shihet si sektor me rëndësi ekonomike për vendin. Në bazë të ligjit për verëra Kosova është e ndarë në dy rajone të vreshtarisë, atë të Dukagjinit dhe të Rrafshit të Kosovës dhe pastaj rajonet janë të ndara në nën rajone (veri dhe jug). Në periudhën e paraluftës, sipërfaqet e kultivuara me vreshta kanë qenë shumë më të mëdha sesa që janë sot. Në vitin 1988 sipërfaqja me vreshta në Kosovë ka qenë rreth 9,000 ha, ndërsa sot në Kosovë kultivohen 3,117 ha, prej të cilave 769 ha janë me rrush tryeze dhe 2,348 ha me rrush për verë. Ngastrat e vreshtave kryesisht janë të vogla me një mesatare prej 0.50 ha, e duke marr parasysh këtë fakt si dhe atë se vreshtat janë të vjetra si dhe mekanizmi i vjetruar, kosto e prodhimit të rrushit është e lartë. Pjesa më e madhe, rreth 75% e vreshtave janë në pronësi të fermerëve ndërsa pjesa tjetër rreth 25% është në pronësi të kompanive prodhuese të verës. Mbështetja përmes pagesave direkte ndikon drejtpërdrejt në uljen e koston së prodhimit, ndërsa përmes masave të zhvillimit rural mbështeten investimet në infrastrukturë dhe makineri në sektorin e prodhimit dhe për punimit të rrushit.

Në periudhën 2010-2016, sipërfaqja mesatare e kultivuar me vreshta në Kosovë ishte 3,152 ha. Në vitin 2016 sipërfaqja me vreshta ishte 3,117 ha, 75% e së cilës ishte e kultivuar me rrush për verë dhe 25% me rrush tryeze. Në krahasim me vitin 2015, sipërfaqja me vreshta në vitin 2016 është rritur për 1.6%. Rritje më të madhe në përqindje në vitin 2016 ka pasur sipërfaqja e kultivuar me rrush tryeze, përkatësisht është rritur për 3%, ndërsa sipërfaqja me rrush për verë 1%. Në vitin 2016 sipërfaqja me rrush tryeze është rritur për 22ha ndërsa ajo me rrush vere për 27 ha. Sa i përket varieteteve të rrushit të tryezës të kultivuara në vitin 2016, 33% e sipërfaqes së kultivuar me rrush tryeze është me Muskat Hamburg, 23% me Muskat Italian, 16% me Afuz Ali, 11% me Kardinal dhe 17% me varietetet tjera që kultivohen në sipërfaqe më të vogla që janë: Moldavkë, Ribier, Demir Kapi, Antigona, Rrush tryeze eksperimental, Viktoria, Black Magic,

Mbretëresha, Groqanka, Red Globe, Muskat Korrikut, Crimson Seedless, Michele Palieridhe - rrush pa farë. Në vitin 2016, nga sipërfaqja totale e kultivuar me rrush për verë, 66% (1,556 ha) ishte e kultivuar me varietete të kuqe ndërsa 34% (792 ha) me varietete të bardha.

Nga varietetet e kuqe, 80% e sipërfaqes ishte e kultivuar me Vranac (441 ha), Prokupë (376 ha), Game (261 ha) dhe Burgundez i Zi (164 ha) dhe 20% me varietete të tjera (314 ha). Sipërfaqja totale e kultivuar në vitin 2016 me varietete të bardha ishte 792 ha, prej së cilës 91% ishte e kultivuar me Smederevkë, Rizlingu Italian, Chardonnay dhe Rizling Rajne ndërsa 9% me varietete të tjera si: Zhuplanka, Burgundez i bardhë, Rrakacitel, Melnik, Semion, Zhillavka, dhe E Bardha e Kladovës.




Figure 1. Rajonet vreshtare të Kosovës

Burimi: MBPZHR, (2021).



Figure 2. Ndarja e varieteteve të rrushit sipas destinimit të prodhimit

Burimi: MBPZHR, (2021).




Figure 3. Struktura e vreshtave në Kosovë

Burimi: MBPZHR, (2021).



*Figure 4. Varieteti i rrushit - Muskat Italia
Burimi: Në Vreshtat tona, (2019).*




Figure 5. Varieteti i rrushit – Victoria

Burimi: Në Vreshtat tona, (2019).

Dallimi në rendiment në mes të dy varieteteve nuk ka pasi që janë të dy varietete që i takojnë familjes së bujshme, d.m.th janë varietete me bujshmeri të lartë, kurse i vetmi dallim tek këto tëdy varietete është tek koha e pjekjes, ku tek varieteti Viktoria koha e pjekjes është mesi i muajit Gusht, kurse tek Varieteti Muskat Italia koha e pjekjes është mesi i shtatorit d.m.th kanë rreth njëmuaj diferencë mes veti.

2.2. Kostoja e prodhimit dhe profitabiliteti

Marrja e vendimit nga ana e një firme për të përcaktuar sasinë e prodhimit apo shërbimit të destinuar për treg, varet nga kostot dhe çmimi i produktit apo shërbimit që ajo prodhon dhe shet. (Pllana, 2013). Kostoja totale shpreh shpenzimet më të ulëta monetare të kryera nga firma, të nevojshme për të prodhuar një nivel të caktuar të produktit. Kosto totale përbëhet nga kosto fikse dhe kosto variabile. Kostot fikse janë ato shpenzime monetare që firma paguan për inputet fikse të prodhimit, të cilat nuk ndryshojnë kur ndryshon prodhimi. (Ahmet M. Sulo H. Dhori K. Stefan Q., 2000). Ato janë shpenzime të pavarura nga çdo aktivitet biznesor. (Investopedia, Fixed Cost) Kosto të ndryshueshme janë shpenzimet monetare që bënë firma, për inputet e ndryshueshme të prodhimit të cilat ndryshojnë në qoftë se ndryshon sasia e prodhimit. (Ahmet M. Sulo H. Dhori K. Stefan Q., 2000).

Kostot fikse janë çelësi për të arritur ekonominë e shkallës, në kuptimin që kompania bënë më shumë profit për njësi dhe profiti rritet përdërisa prodhon më shumë njësi. Një kompani me një numër më të madh të kostove variabile në krahasim me kostot fikse tregon më shumë stabilitet në koston për njësi dhe më shumë qëndrueshmëri në fitimin bruto. Për ato firma që kanë kosto të lartë fikse në qoftë se një gabim relativisht i vogël është bërë në shitje, ai mund të shoqërohet me gabime shumë të mëdha në rrjedhat e parasë. Kur kosto fikse është më e lartë se kosto variabile mund të rritet profiti, pasi që kostoja të mbetet e njëjtë. Një biznes i madh që shet miliona produkte në vit, kontribuon gjithherë e më pak në shpenzimet e koston fikse dhe më shumë në profitabilitet, ai nuk është aq i varur nga çdo shitje individuale. Një firmë e cila bënë pak shitje, me secilën shitje kontribuon në një fitim bruto shumë të lartë dhe thuhet se është në nivel të lartë superiorë. Përkundër kësaj një biznes që bënë shumë shitje, kontribuon më pak në fitim dhe për këtë biznes thuhet se është më i qëndrueshëm (investopedia, 2016).

2.3. Metoda e prodhimit ekonomikisht eficient

Është metodë që prodhon një nivel të caktuar të produktit me koston më të ulët të mundshme. Procesi i Prodimit "eficient ekonomik" duhet të jetë "teknikisht eficient", por prodhimi teknikisht eficient mund të mos jetë ekonomikisht eficient (Jones, 2016).

2.3.1. Efikasiteti teknik në prodhim

Do të thotë që sa më pak inpute të përdoren për të prodhuar një produkt (modernizimi i teknologjisë). Kur firmat zgjedhin të modernizojnë teknologjinë ato janë të interesuara që metodat e prodhimit të kenë kosto sa më të ulët të mundshme (Jones, 2016).

2.3.2. Ekonomia e shkallës

Do të thotë prodhimi bëhet më eficient përderisa numri i produkteve të prodhuara fillon të rritet. Ekonomia e shkallës mund të lindë në disa lëmi të ndërmarrjeve të mëdha, përderisa përfitimet nga ky koncept në lëmit si prodhimi dhe blerja janë të dukshme, ekonomitë e shkallës mund të prekin fusha si financat. Shembull, kompanitë e mëdha shpesh kanë kosto më të ulët të kapitalit sesa kompanitë e vogla. Megjithatë ekziston një kufi i caktuar se sa e madhe mund të jetë një organizatë për të arritur ekonominë e shkallës. Pas arritjes së një madhësie të caktuar ajo bëhet gjithnjë e më e shtrenjtë për tu menaxhuar për një numër arsyesh: përfshirë kompleksitetin e saj, natyrën burokratike dhe jo efikasitetin operativ, kjo dukuri e padëshirueshme është referuar si disekonomi e shkallës (Investopedia, Economies of scale, 2016).

2.3.3. Disekonomitë e shkallës

Zakonisht, por jo gjithmonë fillojnë të ndodhin në firma të mëdha kur me rritjen e prodhimit rritet edhe kostoja, dy arsyet për disekonomi të shkallës janë shpenzimet që bëhen për rritjen e monitorimit (janë kosto të shkaktuara nga organizatorët e prodhimit duke i përcjell punëtorët që të kryejnë punët e duhura për të cilat janë punësuar, si dhe arsyeja e dytë është humbja e shpirtit të ekipit apo ndjenjës së miqësisë dhe pjesëmarrjes në ekip, që i nxjerr përpjekjet më të mira të njerëzve (Jones, 2016).

2.4. Profitabiliteti

Është kur firma i mbulon shpenzimet dhe arrin të mbijetoj, sa më i vogël të jetë pragu i rendimentit apo pika e mbulimit aq më i madh është fitimi.

2.5. Eficienca alokative

Është gjendja e ekonomisë në të cilën prodhimi përfaqëson preferencat e konsumatorit, në mënyrë të veçantë, çdo shërbim të mirë apo që prodhohet deri në pikën ku njësia e fundit siguron një përfitim të vogël për konsumatorët, të jetë e barabartë me koston marginale të prodhimit.

Kjo është për shkak se çmimi që konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë është i barabartë me shërbimet anësore që ata marrin. Prandaj shpërndarja optimale arrihet kur dobia marginale e mirë është e barabartë me koston marginale. Çmimet më të larta se kosto marginale, që ndodhë tek monopolet përbëjnë joeficiencë alokative (Pettinger, 2012).

Eficienca alokative thënë shkurt është kur prodhuesi nuk e dëmton vetveten dhe as konsumatorët. Një shpjegim për efektivitetin alokativ është teoria e paretos ku asnjë riorganizim i produktit nuk mund të bëhet mirë pa e dëmtuar dikë tjetër. Eficienca alokative kërkon që produktet që alokohen përgjatë konsumatorëve ta maksimizojnë kënaqësinë e konsumatorëve (Coursera, 2016). Nëse nuk është efikasitet alokativ atëherë shitja mund ta bëjë dikë më mirë dhe dikë më keq.

2.6. Pika e mbulimit apo pragu i rendimentit

Për firmën, një prej problemeve të rëndësishme është përcaktimi i madhësive të prodhimit dhe shitjes, sipas të cilave firma do të ketë fitim. Pra, me çfarë sasi të prodhimit dhe çfarë sasi të shitjes firma do të fitojë. Pika e mbulimit është niveli i prodhimit kur, të hyrat totale të firmës janë të barabarta me kostot totale dhe në këtë pikë firma nuk ka as humbje e as fitim (Pllana, 2013).

2.7. Gjendja e faktorëve ekonomik dhe social që ndikojnë në kosto të prodhimit

Tani do diskutojmë për komponentët apo faktorët kryesor në kosto të prodhimit

2.7.1. Çmimi

Ne mund të supozojmë se me një rritje minimale të qasjes në treg apo me rënien e tarifave do të shkaktonte një rënie të çmimeve të rrushit në tregun Kanadez. Ndryshimi i çmimit të rrushit në tregun vendor (të brendshëm) varet ndjeshëm nga normat e këmbimit dhe tarifat kufitare, të cilat mund ta izolojnë tregun e brendshëm. Luhatshmëria e madhe e kursit të këmbimit ose një rënie në nivelin e mbrojtjes së kufijve, mund të ndikojë në rritjen e ndryshueshmërisë të çmimit të rrushit (Lota D. Tamini, Maurice Doyon, Micheline M. Zan, 2014).

Tregu Kosovar është i vërshtuar nga produktet e importuara, të cilat mjaft po i dëmtojnë prodhuesit vendor dhe ekonominë e Kosovës në përgjithësi. Duke marrë parasysh të ardhurat e ulëta në Kosovë, rritja e çmimeve sidomos të produkteve bazike ndikon mjaft negativisht në standardin jetësor të popullatës në Kosovë. Kosova ka çmime relativisht të larta në krahasim me

vendet e tjera të BE-së. Kjo, siç u përmend edhe më herët është si rezultat i sasisë së ulët të prodhimit vendor, kostos së lartë të prodhimit dhe pjesëmarrjes së lartë të importit. Kosova si treg i vogël me prodhim të ulët vendor, është shumë e varur nga importi e si rezultat edhe çmimet diktohen nga importi (M.B.P.ZH.R, Raporti i Gjelber, 2015).

Prodhuesit që nuk ndërmarrin rreziqe, prodhojnë më pak në një situatë të pasigurisë së çmimeve se sa në situatën kur çmimet janë më të sigurta. Kohëve të fundit, autorët shqyrtuan dy burime të pasigurisë së çmimeve duke i emëruar si çmimet e outputit dhe çmimet e inputit. Këta autorë pohojnë se rritja e rrezikut të çmimeve (inputeve dhe outputeve) e redukton prodhimin, si prani e pasigurive të shumta, kështu kërkesa për inpute zvogëlohet. Kjo shpjegohet me faktin se pasiguria ndikon edhe në koston e inputeve si dhe në çmimin e produkteve. Megjithatë kjo rënie është më e vogël kur pasiguria prek vetëm çmimet e inputit apo vetëm çmimet e produktit. Informacioni mund të shkaktojë një rënie të perceptimit ndaj rrezikut dhe si pasoj fermerët vijnë në humbje të mëdha në një situatë pa informacion (Lota D. Tamini, Maurice Doyon, Micheline M.Zan, 2014).

2.7.2. Kreditë për Bujqësi

Kreditimi i bujqësisë dhe zonave rurale është në nivel mjaft të ulët. Edhe pse bankat komerciale e kanë rritur kreditimin e përgjithshëm, pjesëmarrja e bujqësisë në kreditë e lejuara është vetëm rreth 2%. Përveç bankave, institucionet financiare dhe mikrofinanciare ofrojnë kredi për bujqësi dhe zona rurale, por interesat janë shumë të larta dhe përballohen me vështirësi. (Riinvest, 2004) Në përgjithësi, sektori i bujqësisë shihet si shumë i rrezikshëm, pasi institucionet financiare ose nuk kuptojnë, ose nuk janë në gjendje t'i menaxhojnë rreziqet specifike të prodhimit dhe të tregut të prodhuesve bujqësorë. Mungesa dhe pasaktësia e të dhënave në Kosovë i kontribuojnë edhe më tej njohjes së pamjaftueshme të sektorit të bujqësisë, e cila çon në norma të larta të interesit dhe kërkesa për shumë kolateral (kufizimi i përballueshmërisë). Për më tepër, shkathtësitë joadekuate teknike, administrimi i biznesit, dhe kultura financiare e klientëve bujqësorë e bëjnë të vështirë financimin e tyre nga ana e institucioneve financiare (kufizimi i aftësisë). Arsyet për një performancë mjaft të dobët të bujqësisë kosovare janë të ndryshme dhe të ndër-lidhura. Një nga çështjet kryesore është e lidhur me mungesën e një klime të përshtatshme që do të krijonte kushte që fermerët të bëhen më konkurrues.

Tregu joefikas i tokës e mban sektorin në nivel të shkallës së ulët, që do të thotë sasi dhe cilësi jo konsistente, kosto të larta (de-ekonomizim i shkallës), produktivitet i ulët, dhe qasje e dobët në tregje. Sistemet e vjetërsuara të ujitjes, makineri bujqësore e pamjaftueshme, mungesa e hapësirave të depozitimit, si dhe një mungesë e përgjithshme e shkathtësive bujqësore i kontribuon edhe më tej zhvillimit të dobët të sektorit. Ekziston një nevojë e madhe për kredi afatgjata për financim. Konkurrenca rajonale në produkte madhore thjeshtë nuk e favorizon Kosovën duke pasur parasysh disavantazhet e saj. Përveç nëse zonat rurale të Kosovës bëhen më dinamike dhe inovative. Përpunuesit bujqësor kanë kushte më të mira dhe paguajnë normat e interesit ndërmjet 10% dhe 20%, varësisht prej madhësisë së tyre, historisë së kreditit dhe faktorëve tjerë. Megjithatë, ata ende ankohen për koston e lartë të huamarrjes. Pjesëmarrësit e takimeve të fokus grupeve sugjeruan një normë interesi prej 7% në mënyrë që financimi i jashtëm të bëhet i përballueshëm (motion). Subvencionimi i kamatave të kredive është mjaft i përhapur në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Disa nga shtetet kanë programe speciale për modernizimin e prodhimtarisë bujqësore, ku jepet një fond garantues që mbështet bankat private për kreditim të prodhuesve që nuk kanë hipotekë. Shembuj të tillë kemi në disa shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore, ku huamarrësit paguajnë një të tretën e kamatës bankës private, ndërsa dy të tretat e kamatës bankës i kompensohet nga buxheti i qeverisë. Ky program në disa shtete është treguar mjaft i suksesshëm, si në Rusi, ku është rritur shumë kreditimi i prodhuesve dhe përpunuesve bujqësorë dhe kthimi i kredisë ka qenë në një shkallë mjaft të lartë, 98.5%. Burimet kryesore për financim të sektorit të bujqësisë janë kryesisht bankat komerciale, institucionet financiare disa mikrofinanciare. Format tjera të huazimit janë ato nga anëtarët e familjes dhe shokët. Arsye tjetër për një proces të ngadalshëm të kreditimit në bujqësi është edhe përvoja jo e mjaftueshme e bankave, si dhe mosbesimi te klientët e rinj, që kryesisht do të jenë nga zonat rurale. Disa kredi të marra për investime në bujqësi janë harxhuar për destinime të tjera (Riinvest, 2004).

2.7.3. Punësimi

Sektori primar, duke përfshirë bujqësinë, është ende një punëdhënës i rëndësishëm në zonat rurale. Si do që të jetë fermat jo profitabile mund të ndalojnë së punuari. (Stefan Bojneca, 2012) Braktisja e tokës mund të ketë ndikim të rëndësishëm socio-ekonomikë dhe kulturorë e tradicionalë në zonat rurale. Bujqësia është kontribuuesi kryesorë në vitalitetin e zonave rurale e

cila përfshinë aspektet sociale ekonomike e kulturore, ajo gjeneron punësim rural, kontribuon në nivelin kritik të popullsisë së nevojshme për mbajtjen e shërbimeve publike (shërbime kulturore, sportive, administrative, rekreacion) , ofron karakteristika si (pejsazhet) tërheqjen e turizmit dhe i mbanë traditat gjallë. (Tamsin Cooper, Kaley Hart, David Baldock , 2009). Kosova ka një sipërfaqe të përgjithshme 10,908 km², me popullsi rezidente prej 1,804,944 banorë, ku 61% e totalit të popullsisë jetojnë në zonat rurale. Shprehur në përqindje, në bujqësi janë të punësuar 26.7% (nga 323,508 persona që janë të punësuar). Ose gjithsej të punësuar 86,620 persona (me orar të plotë). Në numër shumë të vogël janë të punësuarit e rregullt (5,024 persona), punëtorët sezonal dhe ata të kontraktuar (jo të angazhuar direkt).

Në Kosovë vetëm 26.9% e popullsisë në moshë pune është e punësuar, krahasuar me 50.5% në Shqipëri, 39.7% në Serbi, 34.9% në Mal të Zi dhe B. Hercegovinë 31.7%. Nga 41.6% e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 35.3% (176,743 persona) janë të papunë. (M.B.P.ZH.R, Raporti i Gjelber, 2015). Kosova po ballafaqohet me varfëri të gjerë, por jo edhe shumë të thellë. Norma e papunësisë vazhdon të jetë ndër më të lartat në regjion. Sektori i prodhimit është i një niveli jo konkurrues. (Recica, 2009) Të ardhurat mesatare janë 300-350 euro bruto, por shumë familje mbështeten edhe nga të afërmit e tyre në diasporë. Produkti i Brendshëm Bruto për kokë banori në vitin 2011 ka qenë 2.688 Euro. (Prishtinë) Në një Evropë që gjithnjë po plakët, popullsia e Kosovës bënë një përjashtim. Afërsisht një e treta e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare. (Riinvest, 2004).

2.8. Eksporti dhe importi i rrushit

Në vitin 2016, Kosova eksportoi 112 tonë rrush tryeze në vlerë prej 34 mijë €. Sasia e eksportuar e rrushit në vitin 2016 ishte për 84 tonë më e lartë, përkatësisht ishte katërfishuar në krahasim me vitin 2015. Vlera për njësi të rrushit të tryezës të importuar në vitin 2016 ishte 0.30 €/kg, e që ishte për 0.20 €/kg më e ulët sesa ajo në vitin 2015.




Figure 6. Eksporti i rrushit të tryezës 2015-2016, në ton (majtas) dhe në '000 € (djathtas)

Burimi: MBPZHR

Sasia e rrushit të verës që Kosova eksportoi në vitin 2016 ishte 57 tonë më çmim prej 0.20 €/kg. Sasia e rrushit të verës që është eksportuar është rritur për 40 tonë, apo mund të themi se është më e madhe se trefishi i sasisë së eksportuar në vitin 2015.



Figure 7. Eksporti i rrushit për verë 2015-2016, në ton (majtas) dhe në '000 € (djathtas)

Burimi: MBPZHR

Në vitin 2016, nga sasia e rrushit të tryezës prej 112 tonë që është eksportuar, 97% ishte eksportuar në Maqedoni, 2% në Shqipëri dhe 1% në vendet e tjera. Mali i Zi është vendi i vetëm në të cilin në vitin 2016, Kosova ka eksportuar sasinë totale të rrushit të verës prej ton.




Figure 8. Eksporti i rrushit të tryezës (majtas) dhe rrushit për verë (djathtas) sipas shteteve në vitin 2016

Burimi: MBPZHR

Vlera e importit të rrushit të tryezës në vitin 2016 ishte 1.3 mil. €, ndërsa në sasi u importuan 2,624 tonë apo 30% më shumë sesa në vitin 2015. Vlera e importit për njësi (kg) të rrushit të importuar në vitin 2016 ishte 0.48 €/kg për dallim nga viti 2015 që ishte 0.44 €/kg.




Figure 9. Importi i rrushit të tryezës 2015-2016, në ton (majtas) dhe në '000 € (djathtas)

Burimi: MBPZHR

Sasia e importit të rrushit të verës në vitin 2016 ishte pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2015. Në vitin 2016 u importuan 174 tonë rrush të verës në vlerë prej 78 mijë €. Çmimi i importit për njësi të rrushit të verës së importuar në vitin 2016 ishte 0.45 €/kg, ndërsa në vitin 2015 ishte 0.43 €/kg.




Figure 10. Importi i rrushit për verë 2015-2016, në ton (majtas) dhe në '000 € (djathtas)

Burimi: MBPZHR

Nga sasia totale e rrushit të tryezës që është importuar, 55% është importuar nga Maqedonia, 22% nga Greqia, 20% nga Italia dhe 3% nga Shqipëria dhe vendet e tjera. Rrushi i verës në vitin 2016 është importuar 97% nga Maqedonia, 2% nga Shqipëria dhe 1% nga vendet e tjera.




Figure 11. Importi i rrushit të tryezës (majtas) dhe rrushit për verë (djathtas) sipas shteteve në vitin 2016

Burimi: MBPZHR

Eksporti dhe importi i paraqitur në figurën e mëposhtme përfshin të gjitha llojet e rrushit të cilat janë importuar apo eksportuar në vitin 2015 dhe 2016. Këtu janë të përfshira rrushi i tryezës, rrushi i verës dhe lloje të ndryshme të rrushit të thatë. Bilanci tregtar në vitin 2016 rezultoi me vlerë negative prej 1.5 mil. €, e kjo vjen kryesisht si rezultat i importit të rrushit jashtë sezonës. Gjithashtu edhe vlera për njësi të rrushit të eksportuar është pothuajse dyfish më e ulët sesa ajo e rrushit të importuar.




Figure 12. Bilanci tregtar për rrush 2015-2016 në '000 €

Burimi: MBPZHR

2.9. Eksporti dhe importi në vendet e tjera në botë

Në figurën e mëposhtme janë të paraqitura vendet të cilat kanë eksportuar më së shumti rrush në vitet 2014 dhe 2015. Sipas kësaj figure, Kili është vendi që më së shumti ka eksportuar rrush në vitin 2015 dhe 2014 me sasi prej 1 mil. tonë dhe 0.9 mil. tonë respektivisht. Vendet tjera të cilat kanë eksportuar më së shumti rrush në vitin 2015 janë Italia dhe SHBA me nga 0.5 mil. tonë, pasuar nga Turqia, Peru dhe Afrika Jugore me nga 0.4 mil. tonë etj.




Figure 13. Eksporti i rrushit 2014-2015, (vendet që eksportojnë më së shumti), në ton

Burimi: MBPZHR

Sa i përket importit global të rrushit, vendi që ka importuar më së shumti është SHBA-ja me 0.6 mil. tonë, Gjermania dhe Britania e madhe me nga 0.4 mil. tonë, pasuar nga vendet tjera me më pak se 0.4 mil. tonë.




Figure 14. Importi i rrushit 2014-2015, (vendet që importojnë më së shumti), në ton

Burimi: MBPZHR

Çmimet e rrushit të paraqitura në figurën e mëposhtme dallojnë mjaft në mes shteteve. Sipas të dhënave të Eurostatit për vitin 2015, çmimi më i lartë i rrushit të tryezës është në Portugali (1.48 €), dhe ky çmim është rreth 5 herë më i lartë se çmimi më i ulët (0.28 €) i cili është në Maqedoni. Kosova ka çmim relativisht të ulët në krahasim me vendet tjera. Mesatarja e çmimeve të paraqitura më poshtë është 0.72 € ndërsa në Kosovë ky çmim është 23% më i ulët.




Figure 15. Çmimet e rrushit të tryezës në vitin 2015, €/kg

Burimi: MBPZHR

Sa i përket çmimit të rrushit të verës, sipas të dhënave në figurën më poshtë, çmimi më i lartë është në Kroaci (0.61 €) ndërsa më i ulëti në Portugali (0.20 €). Edhe në Kosovë është pothuajse më i ulëti krahasuar me shtetet tjera me çmim prej 0.23 €.




Figure 16. Çmimet e rrushit të verës në vitin 2015, €/kg

Burimi: MBPZHR

2.10. Faktorët ekologjik që ndikojnë në kultivimin e hardhisë së rrushit

Për kultivim të suksesshëm të hardhisë së rrushit, janë të domosdoshme dhe faktor të caktuar të ambientit të jashtëm, pikërisht ato klimatik dhe tokësor. Faktor me të rëndësishëm klimatik janë: temperaturat, rrezatimi diellor, lagështia (reshjet) dhe erërat. Me rëndësi të veçantë nga kushtet tokësore janë, përbërja kimike e tokës dhe vetit fizike të sajë. Nëse të gjitha këto kushte i përgjigjen kërkesave të cilat i ka hardhia e rrushit, mund të priten rendimente të mira dhe kualitet të lartë të rrushit.

2.10.1. Karakteristikat klimatike

Rahoveci shtrihet në pjesën jugperëndimore të territorit të Kosovës. Relievi i kësaj zone vreshtare është kodrinor me lartësi mbidetare prej 370m–650m. Këto kushte specifike orografike, gjerësia gjeografike dhe lartësia e përshtatshme mbidetare i japin një karakter të veçantë klimatik.

2.10.2. Temperatura e ajrit

Temperaturat janë një nga faktorët klimatik më të rëndësishëm për kultivim të suksesshëm të hardhisë së rrushit. Proceset fiziologjike gjatë periudhës vegetative, mund të zhvillohen vetëm në temperatura të caktuara klimatike. Kërkesat e hardhisë së rrushit për temperatura në faza të ndryshme vegetative është e ndryshme. Para se gjithash, për fillimin e një fazë vegetative, duhet të ekzistojnë së paku një shumë e temperaturave minimale. Prandaj është e domosdoshme një analizë e detajuar e temperaturave të ajrit, për të vlerësuar përshtatshmërinë e saj në kultivimin e hardhisë së rrushit.

Table 1. Mesatarja mujore, mesatarja maksimale, mesatarja minimale dhe vjetore e temperaturave të ajrit 2012/18

Emërtimi	Vlera maksimale °C	Vlera mesatare °C	Vlera minimale °C
Janar	7.29	3.44	-0.64
Shkurt	8.41	4.14	0.6
Mars	12.09	7.52	2.76

Prill	18.18	11.63	6.15
Maj	23.44	16.97	10.73
Qershor	26.17	19.79	14.94
Korrik	30.2	23.08	15.96
Gusht	31.2	23.28	16.35
Shtator	26.05	19.11	18.54
Tetor	18.59	12.11	7.75
Nëntor	13.41	7.86	3.42
Dhjetor	6.99	2.91	-0.99
Vjetore	18.43	12.7	7.86

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 1, vërehet se temperaturat më të larta janë në muajin korrik dhe gusht, ndërsa ato më të ulëta janë në muajin janar. Temperatura mesatare e ajrit gjatë fazës vegetative është 17 °C.

Shuma e temperaturave të ajrit për periudhën vegetative është 37 °C, ndërsa për muajin korrik shtator është 18°C.

Temperaturat e ulëta të ajrit mund të jenë faktor limituese për kultivim të hardhisë së rrushit. Qëndrueshmëria e hardhisë ndaj temperaturave të ulëta të ajrit është e ndryshme në periudha të ndryshme vegetative dhe varet nga koha, sasia e paraqitjes së këtyre temperaturave të ulëta, organeve, gjendjes fiziologjike të bimës etj.

Është e njohur se nëse gjatë periudhës së dimrit, paraqiten temperatura të ulëta nën 15°C deri në -18°C, mund të llogaritet në dëmtimin e një numri të konsiderueshëm të sythave pjellor të kultivarët me rezistencë të ulët, siç janë shumica e kultivarëve të rrushit për tryezë.

Në temperatura -20°C, mund të llogaritet si kufiri i qëndrueshmërisë së sythave të kultivarit V. Vinifera. Në temperaturat e ulëta -22 deri -24°C, ngrihen edhe organet shumë vjeçare të hardhisë së rrushit.

Dëme më të mëdha në hardhi të rrushit, nga temperatura të ulëta shkaktohen nga ngricat pranverore, kur fillon edhe faza e mugullimit të sythave dhe zhvillimit të shermendeve, raste të tilla kishim edhe dy vite të fundit, pra gjatë viteve 2016 dhe 2017.

Ndikim negativ kanë edhe temperaturat e larta të ajrit, nëse ato arrijnë në mbi 35⁰C, në mënyrë depressive ndikojnë në procesin e fotosintezës dhe asimilimin e dioksidit të karbonit. Nëse këto temperatura të larta arrijnë në mbi 42⁰C, ato shkaktojnë dëmtime të ndryshme në gjethe, shermende të reja, e sidomos atëherë kur në tokë është mungesë e lagështisë.

Njëri ndër faktorët më rendësi për kultivim të hardhisë se rrushit është edhe kohë zgjatja e periudhës vegetative. Periudhë në zonën e vreshtave të Rahovecit, fillon nga dekada e parë e muajit prill dhe zgjat deri me dekadën e parë të muajit nëntor. Periudha vegetative mesatarisht zgjat 212 ditë. Shuma e temperaturave për këtë periudhë është rreth 37⁰C, e që është mjaft e favorshme për kultivim të hardhisë se rrushit.

2.10.3. Reshjet e shiut

Konsiderohet se hardhia e rrushit është relativisht rezistente ndaj thatësisë, pasi që kultivohet me sukses edhe në zona me reshje relativisht të ulëta. Por, për një kultivim të suksesshëm përveç temperaturave të ajrit, ndriçimit është e domosdoshme edhe lagështia e dheut dhe e ajrit.

Uji ka ndikim të madh në ciklin biologjik të zhvillimit të hardhisë dhe është pjesë përbërëse e ndërtimit të gjitha organeve, e cila merr pjesë në procesin metabolik në lëvizjen e materieve minerale ushqyese, që ndikon në procesin e transpiracioneve dhe frymëmarrjen e bimës.

Vlerat mesatare mujore dhe vjetore e të reshurave, janë të paraqitura në tabelën 2. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërejmë se gjatë vitit reshjet në zonën vreshtarë të Rahovecit janë 855.85 mm³, e cila konsiderohet si optimale.

Table 2. Reshjet mesatare në Rahovec për gjatë viteve 2012-2018

Emërtimi	Vlera mesatare mm³
Janar	70.54
Shkurt	98.87
Mars	113.8
Prill	93.47
Maj	102.6
Qershor	95.98
Korrik	47.54
Gusht	55.58

Shtator	83.32
Tetor	90.2
Nëntor	82.48
Dhjetor	43.67
Vjetore	855.85

Shpërndarja e reshjeve gjatë viteve nuk është e njëjtë, me së shumti reshje kemi gjatë muajve shkurt dhe mars, ndërsa më pak gjatë muajve korrik dhe gusht. Gjatë vegetacionit në zonën vreshtarë të Rahovecit kemi më shumë se gjysma e mesatares se reshjeve vjetore të cilat janë të mjaftueshme për kultivim të suksesshëm të hardhisë së rrushit. Siç duket nga tabela 2, në muajin shtator dhe tetor bijën më shumë se 100mm³ reshje të shiut të cilat kanë efekt negativ në pjekje të rrushit, paraqitje të sëmundjeve e sidomos kalbëzimit *Botritis Cinerea*.

2.10.4. Lagështia relative e ajrit

Njëri ndër faktorët e rëndësishëm për kultivimin e suksesshëm të hardhisë së rrushit është lagështia relative e ajrit. Shumë autor mendojnë se lagështia me favorshme e ajrit për kultivim të rrushit duhet të jetë nga 70-80%. Kërkesat e hardhisë së rrushit ndaj lagështisë relative të ajrit, në faza të ndryshme vegetative është e ndryshme. Po ashtu, për rritjen e sharmendeve (lastarit) lagështia relative e ajrit duhet të jetë, nga 60-70%, për fazë të lulëzimit 55%, për formim dhe rritje të kokrrës në mes 70-80%. Shënime për lagështinë relative të ajrit janë të paraqitura në tabelën 3. Nga këto shënime vërejmë se për periudhën kohore 2012/18, lagështia relative e ajrit është 67.15%.

Table 3. Lagështia relative të ajrit në Rahovec për gjatë viteve 2012-2018

Emërtimi	Vlera mesatare %
Janar	74.97
Shkurt	69.37
Mars	68.2
Prill	61.61
Maj	63.55
Qershor	65.63
Korrik	57.43
Gusht	56.69
Shtator	62.05
Tetor	71.5

Nëntor	74.47
Dhjetor	63.99
Vjetore	67.15

2.10.5. Rrezatimi diellor

Rol të rëndësishëm për kultivim e hardhisë së rrushit ka edhe rrezatimi diellor. Hardhia e rrushit hyn në grupin e bimëve që kërkon më shumë orë me rrezatim diellor. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 4, për periudhën kohore 2012/2018 vërejmë se kohëzgjatja mesatare e rrezatimit diellor ishte 2098 orë. Orë me rrezatim diellorë më së shumti ka gjatë muajve të verës e më së paku gjatë muajve të dimrit.

Table 4. Kohëzgjatja e rrezatimit diellor në orë për periudhën 2012/18

Emërtimi	Vlera mesatare/ore
Janar	64
Shkurt	98
Mars	135
Prill	178
Maj	225
Qershor	252
Korrik	310
Gusht	298
Shtator	230
Tetor	172
Nëntor	83
Dhjetor	58
Vjetore	2098

2.11. Toka

Territori i Komunës së Rahovecit ka llojllojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet me numër të madh të grupeve të llojeve të tokës, e në përbërjen e saj ka 8 lloje dhe 21 nënloje, në formë të një mozaiku.

Prezenca e llojeve të ndryshme të tokave ofron mundësi për zhvillimin e shumë kulturave të ndryshme bujqësore. Pjesa dërmuese e sipërfaqeve me vreshta janë të ngritura në tokat bujqësore të llojit smonic, nënlllojit smonic e eroduar dhe lesivuar. Këto sipërfaqet janë të bonitetit të klasës III-të dhe IV-t. Areali kryesor i kësaj toke shtrihet në ngastrat e këtyre fshatrave: Nashpal, Sapniq, Bërnjak, Reti, Pataçan i Epërm, Pataçan i Ulët, Nogavc, Celinë dhe komunën kadastrale të Rahovecit. Kryesisht këto toka shtrihen në një lartësi mbidetare prej 450m (Shënimet janë të bazuara nga Plani Zhvillimor komunal i Rahovecit, 2011).

2.12. Sëmundjet dhe dëmtuesit

Gjatë tërë fazave të zhvillimit të hardhisë së rrushit, ajo preket nga një numër i konsiderueshëm i patogjenëve dhe dëmtuesve të ndryshëm duke i shkaktuar dëme si në rendiment ashtu edhe në cilësi kësaj kulture VRUGU OSE PERENOSPORA, është një kërpudhë parazitare, shumë e përhapur në të gjitha vreshtat e vendit tonë. Sapo të shfaqen 4-5 gjethet e para dhe në madhësinë 4-5cm, fermerët duhet të interesohen që të kontrollojnë praninë e kësaj sëmundjeje.

Sporet e kësaj kërpudhe mbijnë dhe zhvillohen me shpejtësi mbi gjethet, lastarët, përdredhëset, kryesisht në lulet e hardhisë. Shenjat e para dallohen zakonisht, kur plotësohen tre kushtet e njohura në praktik ose e thënë ndryshe **“RREGULLI I TRI DHJETAVE”**. Kjo duhet kuptuar kështu: **1. Kur lastari arrin gjatësinë 10 cm; 2. Kur temperatura minimale e natës arrin në 10°C; dhe 3. Kur në 24-36 orët e fundit, bien 10 mm reshje.**

Kur ditët janë të ngrohta e me diell dhe shoqërohen me reshje të vazhdueshme, vrugu shfaqet me njolla në formë “vaji”. Kjo formë shfaqjeje mund të shkatërrojë krejtësisht masën vegjetative (gjethet dhe lubrite), në çfarëdo faze qofshin ato. Mënjanimi i dëmtimeve prej vrugut, mund të arrihen vetëm nëse zbatojmë një seri masash me karakter; 1) Parandaluese; dhe 2) Kuruese.

HIRI i rrushit - është një sëmundje e rrezikshme që dimëron në luspat e sythave. Në Pranverë kur temperatura arrin në 7-8°C dhe lastarët e porsa çelura kanë vetëm 2-3 gjethë, sëmundja fillon të aktivizohet dhe të sjell dëme të pallogaritshme. Duhet të vihet mirë parasysh se, shenjat e

sëmundjes në fazat fillestare janë të padukshme nga syri i njeriut. Sëmundja gjënë kushte më të mira dhe zhvillohet me shpejtësi kur temperatura rritet në 25-30°C dhe lagështia e ajrit është e ulët. Sëmundja prek të gjitha organet e gjelbëruara si: lastarët, gjethet, lulerite dhe kokrrat e porsa lidhura dhe vazhdon deri në momentin e pjekjes. Hiri prek vazhdimisht vreshtat tona dhe duhet konsideruar si sëmundja më dëmprurëse në vreshtari.

KALBEZIMI I HIRTE - Kërpudha zhvillohet në Pranverë, kur temperatura e ajrit është rreth 20-25°C dhe në ajër të këtë lagështirë të lartë. Kërpudha që shkakton kalbëzimin e veshulëve të rrushit fillon të strehohet që në pranverë në gjethet, në lastarët e rinj, etj. Për tu bërë pastaj të dukshme në vjeshtë, duke shkaktuar kalbjen e kokrrave të pjekura. Masat mbrojtëse janë të njëjta me ato kundër vrugut. Koha më e përshtatshme për luftimin e kalbëzimit, është periudha Korrik-Gusht. Trajtimet duhet të ndërpriten 20-25 ditë para vjeljes së rrushit.

Dëmtuesit kryesore **TENJA E RRUSHIT** Klisia ose larva e hirte, e cila del nga një insekt i rritur që është flutur me krahë të verdhë ose gështenje, gjëndërohet me 2 deri në 3 brezni gjatë vegjetacionit. Tenja (sidomos faza larvare) është mjaft epërhapur dhe shkakton dëme të konsiderueshme, nganjëherë në fazën e lulëzimit dhe me shpesh në atë të fillimit të pjekjes së kokrrave të rrushit. Frutat që sapo kanë filluar të piquen, pasi infektohen me larvat, fillojnë dëmtimet nga zhvillimi i sëmundjeve kërpudhore.

2.13. Faktorët institucional - Subvencionet

Subvencionimi i vreshtave përmes pagesave direkte ka filluar për herë të parë në vitin 2013, ku janë subvencionuar të gjithë ata fermerë që kultivonin sipërfaqe 0.10 deri 100 ha me vreshta. Subvencionimi ka ndryshuar varësisht madhësisë së sipërfaqes së kultivuar, fermerët me sipërfaqe prej 0.10 deri 100 ha janë subvencionuar me nga 500 €/ha ndërsa ata me sipërfaqe më të mëdha se 100 ha janë subvencionuar me nga 200 €/ha. Në vitin 2014 shuma e subvencioneve që fermerët kanë përfituar është rritur nga 500 në 1,000 € për sipërfaqe prej 0.10 deri 100 ha dhe nga 200 € në 300 € për sipërfaqe më të madhe se 100 ha.

Në vitin 2015 subvencionimi vazhdoi me shumë të njëjtë sikurse në vitin 2014 për të pësuar ndryshim në vitin 2016 vetëm për fermerët që aplikonin për sipërfaqe më të madhe se 100 ha e të cilët përfituan nga 400 €/ha, ndryshe nga dy vitet paraprake kur shuma që përfitonin për sipërfaqe të njëjtë ishte 300 €/ha.

Shuma mesatare e pagesave direkte në periudhën 2013-2016 është 7.6 mil. €. Më e larta është në vitin 2014 përkatësisht 2.3 mil. €, ndërsa më e ulëta në vitin 2013 që ishte viti i parë i fillimit të mbështetjes përmes pagesave direkte. Numri i ha të mbështetur në vitin 2016 ishte për 0.7% më i madh sesa në vitin 2015, ndërsa shuma e paguar ishte 3.5% më e lartë, përkatësisht 2.1 mil € në vitin 2016. Përqindja e fermerëve të refuzuar në dy vitet e fundit ishte rreth 3.5%.

Në regionin e Gjakovës është 87% e sipërfaqes së mbështetur dhe 13% në regionet e tjera. Ndërsa sa i përket komunave, komunat në të cilat janë të kultivuara dhe të mbështetura sipërfaqet më të mëdha me rrush janë Rahoveci, Suhareka dhe Prizreni, përkatësisht 96% e sipërfaqes së përgjithshme të mbështetur përmes pagesave direkte.




Figure 17. Pagesat direkte për fermerët me hardhi rrushi për gjatë viteve 2012-2016

Burimi: MBPZHR

2.14. Masat e zhvillimit rural në Kosovë

Në vitin 2016, buxheti për mbështetje në kuadër të **masës 101** (Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore) ishte 14.5 mil. € apo 63% nga buxheti total i ndarë për grante. Për sektorin e rrushit në kuadër të kësaj mase në vitin 2016 ishin të ndara 800,000 €.

Në vitin 2016, u ngritën 44.5 ha sipërfaqe të reja me vreshta dhe shuma totale e mbështetjes publike ishte 577 mijë €. Sipas vlerësimit të bërë lidhur me fuqinë punëtore të nevojshme për një ha me vreshta, e që është 1 punëtor i rregullt me orar të plotë të punës mund të kujdeset për 2.7 ha me vreshta, rezulton se në vitin 2016 më ngritjen e 44.5 ha me vreshta të reja janë krijuar 16

vende të reja të punës. Në vitin 2015, 55.5 ha ishte sipërfaqja e re e ngritur me vreshta dhe shuma totale e përkrahjes publike në kuadër të kësaj nën mase ishte 350 mijë €.

Objektiva të përgjithshme të kësaj mase ishin (masës 101):

- ✓ Rritja e aftësisë konkurruese dhe zvogëlimi i importit;
- ✓ Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale;
- ✓ Përkrahja e bujqve me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së;
- ✓ Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse; dhe
- ✓ Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

Objektiva të veçanta për sektorin e rrushit ishin:

- ✓ Rritja e prodhimit të rrushit të tryezës dhe rrushit të verës;
- ✓ Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së;
- ✓ Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- ✓ Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e produkteve të tyre;
- ✓ Modernizimi i fermave përmes përdorimit të fidanëve cilësorë dhe mekanizimit modern;

Përveç kriterëve të përbashkëta të pranueshmërisë në kuadër të kësaj mase, kriteret e veçanta të pranueshmërisë për sektorin e rrushit ishin si në vijim:

- Aplikuesi duhej të kishte tokë në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe atë së paku 0.3 ha për rrush tryeze dhe 0.6 ha për rrush të verës, sipërfaqja minimale e ngastrës duhej të ishte 0.1 ha për rrush tryeze dhe 0.3 ha për rrush të verës;
- Për investime në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes, aplikuesit duhej të dëshmonin se kishin së paku 3 ha me vreshta në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10-të vjet dhe të regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe Regjistrin e Fermës;

- Gjatë investimeve në ngritje të vreshtave të reja duhej të përdreshin vetëm fidanë të importuar nga vendet e BE-së dhe kjo duhej të dëshmohej me certifikatë fito-sanitare, me certifikatë mbi prejardhjen e origjinës dhe me lejen e importit të ndërmarrjes importuese;
- Përveç fidanëve të importuar nga vendet e BE-së përfituesit mundeshin të përdornin edhe fidanë të varieteteve autoktone të rajonit si: Vranac, Kallmet, Prokupë, Smederevkë dhe këtë duhej ta dëshmonin me certifikatë fito-sanitare, me certifikatë mbi prejardhjen e origjinës dhe me lejen e importit të ndërmarrjes importuese;

Në kuadër të investimeve të pranueshme për sektorin e rrushit ishin të përfshira:

- Investimet në ngritje/modernizim të plantacioneve me vreshta (konvertim/zëvendësim) për rrush të tryezës dhe rrush të verës, me madhësi minimale prej 0.3 ha për rrush tryeze dhe 0.6 ha për rrush të verës;
- Investimet për vendosje të sistemeve të ujitjes sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet për vendosje të plasmasit për rrush të tryezës;
- Investime për prodhimin e energjisë efikase në fermë nga burime të ripërtërishme;
- Investimet në vendosjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- Investimet në sistemet mbajtëse të hardhive dhe rrethojave;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investime për ndërtim të objekteve për veprime pas vjeljes vetëm për fermerët që kishin mbi 3 ha sipërfaqe me vreshta.

Të pranueshme ishin edhe shpenzimet për përgatitje të planit të biznesit apo projekt propozimit por që nuk mund të kalonin 3% të vlerës të shpenzimeve të pranueshme si dhe në rast kur parashihej ndërtimi i objekteve shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, leje dhe licence ishin të pranueshme deri në 7% të vlerës të shpenzimeve të pranueshme.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për sektorin e rrushit në kuadër të kësaj mase ishte 5,000 € ndërsa vlera maksimale 100,000 €. Shkalla e përkrahjes publike ishte 60% e vlerës së shpenzimeve të pranueshme të investimit dhe përkrahje shtesë prej 5% jepej për

investime në zona malore dhe 5% për fermerët e rinj (40 vjeç ose më të rinj)¹.

KAPITULLI 3

3. METODOLOGJIA DHE METODAT

3.1 Metodologjia dhe Metodat e aplikuara

Metodologjia dhe metodat e përdorura në këtë hulumtim kanë qenë në natyrshmeri me karakterin përkatës të studimit në fjalë që është bërë. Fillimisht autori ka filluar punën me konsultimin e materialeve të ndryshme shkencore për tu njohur më shumë me sektorin/ industrinë, në mënyrë që të i jepet një kahje sa më e drejtë këtij studimi dhe në mënyrë që të ishte sa më i mirëfilltë dhe i kuptueshëm edhe për studiuesit e dorës së parë. Pasurimi i përmbajtjes së këtij punimi u bë me shumë të dhëna sekondare të nxjerra dhe prezantuara përgjatë këtij punimi në mënyrë që të sqarohet sa më drejt perceptimi i lexuesit të këtij punimi.

Mbledhja e të dhënave primare për këtë studim u bë përmes intervistave të drejtpërdrejta me konsumatorë të zgjedhur në mënyrë rastësore. Ky punim bazohet në të dhënat e marra nga 31 fermer vreshtarë.

Kryqëzimi (Crosstabulation) është mjet i shpeshtë i përdorur në këtë studim - që paraqet një mënyrë e vizualizimit të të dhënave statistikore, që mund të na ndihmojë të kuptojmë lidhjen midis dy variablva (ndryshoreve) të përcaktuara.

Në anën tjetër edhe Chi-Square test është një mjet statistikor që ka ndihmuar autorin e punimit të vlerësoj se nëse ka një lidhje midis dy variablave (ndryshoreve) të caktuara. Në rastin tonë, mund të aplikojmë Chi-Square test për të vlerësuar se nëse ka një lidhje midis varietetit të rrushit dhe numrit të hektarëve që u kushtohen këtyre varieteteve. Pastaj, mund të aplikojmë Chi-Square test

¹MBPZHR, departamenti i analizave ekonomike dhe statistikave bujqësore, 2017

duke përdorur një nivel besueshmërie të caktuar (p.sh. 0.05 ose 0.01). Rezultati i këtij testi do të na tregojë se nëse ka një lidhje statistikisht të rëndësishme midis varietetit të rrushit dhe numrit të hektarëve që u kushtohen këtyre varieteteve.

Në rast se testi tregon se ka një lidhje statistikisht të rëndësishme midis këtyre dy variablave, kjo do të na ndihmojë të kuptojmë se cili varietet është më i preferuar në nivel global në kushtet e dhëna të hektarëve të rrushit, dhe mund të na ndihmojë në identifikimin e mundësive të ndryshme për fermerët dhe investitorët në këtë sektor.

KAPITULLI 4

4. REZULTATET DHE DISKUTIMI

4.1. Hyrje ne kapitullin e rezultateve

Rezultate e futura në tabelën 5, na treguan nga kryqëzimi i realizuar nga analiza crosstabs, në mes të varietetit të rrushit dhe numri i hektarëve kemi rezultatin nga 31 fermer meshkuj që ishin pjesëmarrës në hulumtim prej tyre deri ne 0.3 ha ishin 4 fermerë, apo 25%, 0.3-0.5 ha ishin 14 fermer apo 45.2% dhe numri i fermerëve mbi 0.5 ha ishin 13 fermer apo 41.9% e të intervistuarve. Numri i fermerëve që kanë të mbjella varietetin e rrushit Muskat i Italisë janë 16 fermerë apo 51.6% të shprehura në përqindja, ndërsa numri i fermerëve që kanë të mbjella varietetin e rrushit Viktoria janë 15 fermerë apo 48.4%.

Në rastin tjetër në Figuren 18, shihet se numri i hektarëve të rrushit për secilën varietet është treguar në kolonat e varieteteve të rrushit. Kjo na ka ndihmuar të shohim se cila varietet është më popullore në nivel vendi, tek fermerët e vegjël në Rahovec, që kanë të mbjella varietetet e rrushit të tryezës deri në 1 ha. Kjo analizë statistikore mund të bëhet edhe më e detajuar duke shtuar kategori të tjera, si p.sh. sipërfaqja e hektarëve të rrushit për secilin vend ose rajon, ose të dhënat e prodhimit të rrushit për secilën varietet.

Në këtë mënyrë, kryqezimi na ka ndihmuar të kuptojmë lidhjen midis varietetit të rrushit dhe numrit të hektarëve që u kushtohen këtyre varieteteve, dhe mund të na ndihmojë në identifikimin e mundësive të ndryshme për fermerët dhe investitorët në këtë sektor.

4.2. Raporti në mes varitetit të rrushit dhe numrit të hektarëve

Table 5. Raporti i Varietetit të rrushit dhe numri i hektarëve - Crosstabulation

		Numri i hektarëve			Total
		0 - 0.3	0.3 - 0.5	mbi 0.5	
Variateti Muskat i Italisë	Count	4	5	7	16
	% Varieteti	25.0%	31.2%	43.8%	100.0%
	% Numri i hektarëve	100.0%	35.7%	53.8%	51.6%
	% of Total	12.9%	16.1%	22.6%	51.6%
Viktoria	Count	0	9	6	15
	% Variteti	.0%	60.0%	40.0%	100.0%
	% Numri i hektarëve	.0%	64.3%	46.2%	48.4%
	% of Total	.0%	29.0%	19.4%	48.4%
Total	Count	4	14	13	31
	% Varieteti	12.9%	45.2%	41.9%	100.0%
	% Numri i hektarëve	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
	% of Total	12.9%	45.2%	41.9%	100.0%

Në tabelën e mëposhtme tregohet fakti se në bazë të analizës të testit Chi-Square test ku vlera e nivelit të besueshmërisë është $P < 0.05$, atëherë mund të pohojmë se lidhshmëria ndërmjet varietetit të rrushit dhe numrin e hektarëve të mbjella me rrush nuk është statistikisht signifkante, $X^2 5.193$, $P = 0.075$.

Table 6. Raporti i Varietetit të rrushit dhe numri i hektarëve - Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	5.193 ^a	2	.075
Likelihood Ratio	6.749	2	.034
Linear-by-Linear Association	.729	1	.393
N of Valid Cases	31		

a. 2 cells (33.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.94.

4.3. Varieteti i rrushit dhe numri i hektarëve të fermerëve

Në figurën 18, janë të prezantuara varietetet e rrushit të mbjella nga fermerët në raport me numrin e hektarëve që posedojnë fermerët




Figure 18. Varieteti i rrushit dhe numri i hektarëve të fermerëve, pjesë e hulumtimit tonë

Në bazë të kësaj mund të pohojmë se objekt studimi ka qenë që pjesa e hulumtimit të jenë fermerët që kanë në posedim hapësira jo të mëdha të rrushit të mbjella në mënyrë që ti analizojmë tri parametrat kryesore që janë të prezantuar në këtë hulumtim, e që janë të treguar gjerësisht tek pjesa e përfundimeve.

Për të bërë një analizë të varieteteve të rrushit dhe numrit të hektarëve që u kushtohen këtyre llojeve, është e rëndësishme të mblidhen të dhëna nga burime të ndryshme si institucione shtetërore, organizata të fushës, dhe fermerë individualë.

Në përgjithësi, ekzistojnë shumë varietete të rrushit që kultivohen në Rahovec, dhe numri i hektarëve që u kushtohen varieteteve të ndryshme varet nga kërkesa dhe tregu lokal dhe ndërkombëtar (global). Në disa vende, varietetet e kuqe dhe të bardha janë më të preferuara, ndërsa në vende të tjera, mund të jenë më të popullarizuara varietetet e verës së kuqe ose verës së bardhë.

Në përgjithësi, varietetet më të kultivuara të rrushit përfshijnë Chardonnay, Cabernet Sauvignon, Pinot Noir, Merlot, Syrah, Sauvignon Blanc, Riesling dhe shumë të tjera. Nëse analizojmë numrin e hektarëve që i kushtohen këtyre llojeve të rrushit në nivel ndërkombëtar/global, do të vërehet se varietetet e ndryshme kanë një përhapje të ndryshme në vende dhe rajone të ndryshme.

Për të përfunduar, për të bërë një analizë të varieteteve të rrushit dhe numrit të hektarëve që u kushtohen këtyre varieteteve, duhet të merret në konsideratë konteksti dhe tregu lokal dhe ndërkombëtar. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e mundësive për fermerët dhe investitorët për të investuar në këtë sektor dhe për të ndihmuar në rritjen e prodhimit të rrushit.

4.4. Varieteti i rrushit dhe Kthimi në investim

Në tabelën numër 7, janë të prezantuara kryqëzimet në mes të varietetit të rrushit dhe kthimit në investim të fermerëve, ky lloj i analizave mund të bëhet edhe më i detajuar duke shtuar kategori të tjera, si p.sh. shuma e investimeve për secilin vend ose rajon, ose të dhënat e prodhimit të verës për secilën varietet.

Në këtë mënyrë, kryqëzimi (crosstabulation) na ka ndihmuar të kuptojmë lidhjen midis varietetit të rrushit dhe numrit të investimeve që u kushtohen këtyre varieteteve, dhe mund të na ndihmojë në identifikimin e mundësive të ndryshme për investitorët në këtë sektor.

*Table 7. Varieteti i rrushit * Kthimi në investim - Crosstabulation*

			Kthimi ne investim				Total
			0 - 20	21 - 40	41 - 60	mbi 60	
Varieteti Muskat i Italisë	Count		2	5	7	2	16
	% Variteti		12.5%	31.2%	43.8%	12.5%	100.0%
	% Kthimi ne investim		100.0%	71.4%	58.3%	20.0%	51.6%
	% of Total		6.5%	16.1%	22.6%	6.5%	51.6%
Viktoria	Count		0	2	5	8	15

	% Varieteti	.0%	13.3%	33.3%	53.3%	100.0%
	% Kthimi ne investim	.0%	28.6%	41.7%	80.0%	48.4%
	% of Total	.0%	6.5%	16.1%	25.8%	48.4%
Total	Count	2	7	12	10	31
	% Varieteti	6.5%	22.6%	38.7%	32.3%	100.0%
	% Kthimi ne investim	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
	% of Total	6.5%	22.6%	38.7%	32.3%	100.0%

Në bazë të analizës të testit Chi- Square test ku vlera e nivelit të besueshmërisë është $P < 0.05$, atëherë mund të pohojmë se lidhshmëria ndërmjet varietetit të rrushit dhe kthimit në investim të fermerëve nuk është statistikisht e rëndësishme, $X^2=7.194$, $P= 0.066$.

*Table 8. Varieteti i rrushit * Kthimi në investim - Chi-Square Tests*

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	7.194 ^a	3	.066
Likelihood Ratio	8.258	3	.041
Linear-by-Linear Association	6.525	1	.011
N of Valid Cases	31		

a. 5 cells (62.5%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .97.

Rezultati i këtij testi, na tregojë se, nëse ka një lidhje statistikisht të rëndësishme midis varietetit të rrushit dhe numrit të investimeve që u kushtohen këtyre varieteteve. Në rast se testi tregon se ka një lidhje statistikisht të rëndësishme midis këtyre dy variablave, kjo do të na ndihmojë të kuptojmë se cila varietet është më e preferuar nga investitorët në kushtet e dhëna të investimeve, dhe mund të na ndihmojë në identifikimin e mundësive të ndryshme për investitorët në këtë sektor.




Figure 19. Varieteti i rrushit dhe kthimi në investime, pjesë e hulumtimit tonë

Në figurën 19, janë të prezantuara varietetet e rrushit të mbjellur nga fermerët në raport me kthimin në investim, në bazë të kësaj mund të pohojmë se objekt studimi ka qenë që pjesa e hulumtimit të jenë fermerët që kanë në posedim hapësira jo të mëdha të rrushit të mbjella në mënyrë që ti analizojmë tri parametrat kryesore që janë të prezantuar në këtë hulumtim.

Varieteti i rrushit dhe kthimi në investime mund të shihen si dy variabla të ndryshme në studimin e tregut të prodhimit të rrushit. Kthimi në investime mund të përkthehet si fitimi apo të ardhurat që fitohen nga investimet në prodhimin e rrushit. Ndërsa varietetet e rrushit mund të ndikojë në cilësinë e rrushit dhe në kërkesën dhe të ardhurat që prodhuesit mund të fitojnë nga shitja e produkteve të tyre.

Në këtë kuptim, mund të kemi dy pyetje kryesore:

1. **A ndikon varieteti i rrushit në kthimin në investime të fermerëve?** - Për të përgjigjur pyetjen e parë, mund të analizojmë të dhënat statistikore të investimeve në secilën varietet të

rrushit, dhe të shohim nëse ka një ndryshim statistikor në kthimin në investime midis varietetit të rrushit;

2. **Cila varietet është më e preferuar nga investitorët dhe ka kthim më të lartë në investime?** - Për të përgjigjur pyetjen e dytë, mund të krahasojmë kthimin në investime për secilën varietet të rrushit dhe të identifikojmë varietetin që ka kthim më të lartë në investime, në mënyrë që të ndihmojmë fermerët dhe investitorët në vendimarrjen e tyre për të investuar në prodhimin e verës.

4.5. Varietetet e rrushit dhe kostoja e prodhimit

Në tabelën 9, janë të prezantuar rezultatet e raportit në mes të varietetit të rrushit dhe koston e prodhimit. Varieteti i rrushit dhe kostoja e prodhimit janë dy faktorë të rëndësishëm në prodhimin e verës, dhe analiza e kryqëzimit (crosstabulation), na ka ndihmuar të kuptojmë si ndikojnë variablat e rrushit në koston e prodhimit. Për të kryer një crosstabulation-analizë midis variablave të rrushit dhe koston e prodhimit, mund të ndahen shifrave të koston së prodhimit sipas llojit të rrushit dhe të vlerësohet nëse ka ndonjë ndryshim në koston e prodhimit për llojin e rrushit të caktuar.

Nëse ka ndryshime në koston e prodhimit, atëherë mund të identifikohen arsyet e këtyre ndryshimeve. Këto arsye mund të përfshijnë faktorë si lloji i tokës, klima, kushtet e kultivimit, metoda e prodhimit dhe ajo se si u rregullohen plantat e rrushit.

Për fermerët, kjo analizë mund të ndihmojë në marrjen e vendimeve më të mira në lidhje me llojin e rrushit që duhet të kultivohet dhe metodat më të mira për të reduktuar koston e prodhimit. Kështu ata mund të optimizojnë shpenzimet e tyre dhe të rrisin efikasitetin e prodhimit të verës.

*Table 9. Varieteti i rrushit * Kosto e prodhimit - Crosstabulation*

		Kosto e prodhimit			Total
		0 - 0.25	0.26 - 0.35	0.36 - 0.50	
Varieteti	Muskat i Italisë	8	1	7	16
	Count				
	% Varieteti	50.0%	6.2%	43.8%	100.0%

Viktoria	% Kosto e prodhimit	47.1%	20.0%	77.8%	51.6%
	% of Total	25.8%	3.2%	22.6%	51.6%
	Count	9	4	2	15
	% Varieteti	60.0%	26.7%	13.3%	100.0%
	% Kosto e prodhimit	52.9%	80.0%	22.2%	48.4%
Total	% of Total	29.0%	12.9%	6.5%	48.4%
	Count	17	5	9	31
	% Varieteti	54.8%	16.1%	29.0%	100.0%
	% Kosto e prodhimit	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
	% of Total	54.8%	16.1%	29.0%	100.0%

Analiza Chi-Square është përdoruar për të vlerësuar nëse ka një lidhje statistikisht të rëndësishme midis variablave të rrushit dhe koston e prodhimit. Ky test mund të përdoret për të vlerësuar nëse ndryshimet në llojin e rrushit kanë një ndikim të rëndësishëm në koston e prodhimit. Për të kryer analizën Chi-Square, mund të ndahen të dhënat e kostos së prodhimit sipas llojit të rrushit dhe të kryhet testi për të vlerësuar nëse ka ndonjë ndryshim në kostot e prodhimit nëpërmjet variablave të rrushit. Nëse testi i Chi-Square tregon një ndikim statistikisht të rëndësishëm të variablave të rrushit në koston e prodhimit, atëherë mund të identifikohen arsyet e këtij ndikimi.

Për fermerët, një analizë Chi-Square e këtyre variablave ka ndihmuar në marrjen e vendimeve më të mira në lidhje me llojin e rrushit që duhet të kultivohet dhe metodat më të mira për të reduktuar kostot e prodhimit. Kështu ata mund të optimizojnë shpenzimet e tyre dhe të rrisin efikasitetin e prodhimit të verës.

Në bazë të analizës të testit Chi-Square test ku vlera e nivelit të besueshmërisë është $P < 0.05$, atëherë mund të pohojmë se lidhshmëria ndërmjet varietetit të rrushit dhe koston së prodhimit të fermerëve nuk është statistikisht signifikante, $X^2=4.609a$, $P= 0.100$.

*Table 10. Varieteti i rrushit * Kosto e prodhimit - Chi-Square Tests*

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	4.609 ^a	2	.100
Likelihood Ratio	4.896	2	.086
Linear-by-Linear Association	1.585	1	.208
N of Valid Cases	31		

a. 4 cells (66.7%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.42.




Figure 20. Varieteti i rrushit dhe kosto e prodhimit, pjesë e hulumtimit tonë

Në figurën 20, janë të prezantuara varietetet e rrushit të mbjellur nga fermerët në raport me koston e prodhimit, në bazë të kësaj mund të pohojmë se objekt studimi ka qenë që pjesa e hulumtimit të jenë fermerët që kanë në posedim hapësira jo të mëdha të rrushit të mbjella në mënyrë që ti analizojmë tri parametrat kryesore që janë të prezantuar në këtë hulumtim.

Varieteti i rrushit dhe kostoja e prodhimit janë dy faktorë të rëndësishëm në prodhimin e rrushit dhe kryerja e një analize ndërvepruese midis tyre mund na ka ndihmuar të kuptojmë marrëdhënien midis këtyre dy variablave.

Për të vlerësuar marrëdhënien midis variablave të rrushit dhe koston e prodhimit të rrushit, mund të përdoren teknika statistikore të ndërveprimit si analiza korelacionit dhe analiza regresionit. Analiza korelacionit do të na tregojë nëse ka ndonjë marrëdhënie lineare midis këtyre dy variablave, ndërsa analiza regresionit do të na ndihmojë të vlerësojmë ndikimin e variablave të rrushit në koston e prodhimit.

Për fermerët, kjo analizë mund të ndihmojë në marrjen e vendimeve më të mira në lidhje me llojin e rrushit që duhet të kultivohet dhe metodat më të mira për të reduktuar kostot e prodhimit. Kështu ata mund të optimizojnë shpenzimet e tyre dhe të rrisin efikasitetin e prodhimit të verës.

KAPITULLI 5

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1 Konkluzionet e studimit

Sipas hulumtimit janë arritur disa përfundime nga realizimi i studimit duke filluar nga ajo që fermerët kanë në posedim me tri analiza kryesore e që janë:

5.2. Tri përfundimet e studimit

1. **Raporti në mes të varieteti i rrushit dhe numri i hektarëve të mbjella nga fermerët -**

Analiza midis varietetit të rrushit dhe numrit të hektarëve të mbjella nga fermerët mund të na ndihmojë të kuptojmë preferencat dhe praktikat e fermerëve në kultivimin e rrushit. Për të krijuar një raport midis këtyre dy variablave. Në këtë mënyrë, mund të vlerësohet se cilat varietetet e rrushit janë më të preferuara nga fermerët dhe nëse ka ndonjë ndryshim në numrin e hektarëve të mbjella midis varietetit të rrushit.

Nëse dëshirojmë të kuptojmë se cilat varietetet e rrushit janë më të pëlqyera nga fermerët, mund të përdorim një indeks preferencash të treguar nga numri i hektarëve të mbjellur për secilin varietet të rrushit. Kjo mund të na ndihmojë të identifikojmë varietetet e rrushit që kanë më shumë kërkesë në treg dhe të ndihmojë fermerët të zgjedhin llojin e rrushit që ata do të duan të kultivojnë në të ardhmen. Kjo analizë mund të ndihmojë fermerët në marrjen e vendimeve më të mira në lidhje me caktimin e hektarëve për secilin lloj varietetit të rrushit dhe të ndihmojë në optimizimin e prodhimit të tyre.

2. **Raporti në mes të varieteti i rrushit dhe kthimi në investim nga fermerët -**

Analiza midis varietetit të rrushit dhe kthimit në investim nga fermerët mund të na ndihmojë të kuptojmë cilat varietetet e rrushit janë më të fituara për të prodhuar dhe cilat mund të kenë nevojë për investime shtesë për të arritur një kthim të mirë në investim. Në këtë mënyrë, mund të vlerësohet se cilat varietetet e rrushit ofrojnë një kthim të mirë në investim dhe cilat nuk janë aq të fitueshme. Nëse dëshirojmë të kuptojmë se cilat varietetet e rrushit kanë më shumë mundësi të ofrojnë një kthim të mirë në investim, mund të përdorim një indeks të treguar nga raporti midis kthimit në investim dhe shpenzimeve të përdorura për prodhimin e secilit varietet të rrushit. Kjo mund të na ndihmojë të identifikojmë varietetet e rrushit që janë më të fitueshme dhe të ndihmojë fermerët të vendosin se cilat varietetet të rrushit duhet të kultivojnë

për të arritur një kthim të mirë në investim. Kjo analizë mund të ndihmojë fermerët në planifikimin e investimeve të tyre në varietetet e rrushit dhe të ndihmojë në përmirësimin e kthimit në investim të tyre.

3. Raporti ne mes të varieteti i rrushit dhe kosto e prodhimit të rrushit nga fermerët -

Analiza midis varietetit të rrushit dhe kosto e prodhimit të rrushit nga fermerët mund të na ndihmojë të kuptojmë cilat varietetet e rrushit janë më të shtrenjta për të prodhuar dhe cilat janë më të lira. Në këtë mënyrë, mund të vlerësohet se cilat varietetet e rrushit janë më të shtrenjta për të prodhuar dhe cilat janë më të lira. Nëse dëshirojmë të kuptojmë se cilat varietetet e rrushit kanë më shumë mundësi të jenë më të lira për të prodhuar, mund të përdorim një indeks të treguar nga raporti midis kostos së prodhimit dhe kuantitetit të prodhuar të secilit varietet të rrushit. Kjo mund të na ndihmojë të identifikojmë varietetet e rrushit që janë më të lira dhe mund të ndihmojë fermerët të vendosin se cilat varietet të rrushit duhet të kultivojnë për të minimizuar shpenzimet e tyre. Kjo analizë mund të ndihmojë fermerët në planifikimin e shpenzimeve të tyre në varietetet e rrushit dhe të ndihmojë në përmirësimin e rentabilitetit të tyre.

Nga fermerët e intervistuar kanë pohuar se janë 16 fermerë apo 51.6% e të intervistuarve që kanë të mbejllur Muskat të Italisë dhe 15 apo 48.4% kanë të mbejllur varietetin e rrushit Viktoria. Pjesë e hulumtim kanë qenë 31 fermerë.

Në të shumtën e studimeve është duke u pohuar se kërkesa e konsumatorëve për rrushin e tryezës siç është rasti në hulumtimin tonë del se është duke u rritur, andaj fermerët duhet të orientohen në rritjen e kapaciteteve prodhuese të tyre në mënyrë që ti mbulojnë kërkesat e konsumatorëve. Në hulumtim kemi arritur të mbledhim të dhëna ku pastaj me rezultatet e tyre kemi arritur të shikojmë se ku qëndrojnë dallimet e ndjeshme në mes të tri faktorëve kryesore e që janë pjesë kryesore e hulumtimit.

Sipas rezultateve të arritura nga të intervistuarit, varieteti i rrushit në raport me numrin e hektarëve nuk ka treguar që ka nivel të ndjeshmërisë (Në bazë të analizës të testit Chi - Square test ku vlera e nivelit të besueshmërisë është $P < 0.05$, atëherë mund të pohojmë se lidhshmëria

ndërmjet varietetit të rrushit dhe kthimit në investim të fermerëve nuk është statistikisht signifkante, $X^2=7.194$, $P= 0.066$).

Për të studiuar variantet e rrushit dhe mundësitë e investimeve në këtë fushë, duhet të bëhet një analizë e thellë e tregut dhe tendencave aktuale në industrinë e prodhimit të verës dhe produkteve të tjera të bazuara në rrush. Disa nga variantet e rrushit që mund të hulumtohen dhe analizohen përfshijnë varietete si Chardonnay, Cabernet Sauvignon, Pinot Noir, Merlot, Syrah, Sauvignon Blanc, Riesling dhe shumë të tjera.

Në kërkimin për investime në këtë fushë, mund të hulumtohen mundësitë për prodhimin e verës dhe produktet e tjera të bazuara në rrush, siç janë verërat me etiketën e kuqe dhe të bardha, verërat shumë të rëndësishme dhe të specializuara, prodhimi i verës bio dhe organike, prodhimi i verës në zona të caktuara dhe të specializuara të kultivimit të rrushit, si dhe shfrytëzimi i teknologjive të fundit për të përmirësuar cilësinë dhe produktivitetin.

Në përfundim, kërkimi në këtë fushë mund të sjellë informacione dhe mundësi të ndryshme për të investuar në rrush, të gjitha të varura nga kushtet lokale dhe globale të tregut. Në këtë mënyrë, mund të bëhet një vendim i informuar për të investuar në rrush dhe të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen nga kjo industri e rëndësishme.

5.3. Rekomandimet

Bazuar në raportet midis varietetit të rrushit, numrit të hektarëve të mbjellur, koston e prodhimit dhe kthimit në investim nga fermerët, mund të bëhen disa rekomandime për fermerët që do të kultivojnë rrushin:

1. Përdorni varietetet e rrushit që përshtaten më mirë me klimën dhe kushtet e tokës tuaj. Kjo do të ndihmojë në rritjen e prodhimit dhe uljen e koston e prodhimit në të njëjtën kohë;
2. Identifikoni varietetet e rrushit që kanë një cikël rritjeje të shpejtë dhe të maturizimit të shpejtë. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe do të rrisë kthimin në investim;
3. Vendosni kufizime të arsyeshme në numrin e hektarëve të mbjellur me rrush. Nëse numri i hektarëve të mbjellur është shumë i madh, kjo mund të rrisë koston e prodhimit dhe të ulë kthimin në investim;
4. Monitoroni dhe vlerësoni koston e prodhimit dhe shpenzimet e tjera të lidhura me kultivimin dhe prodhimin e rrushit. Në këtë mënyrë, do të mund të bëni një kalkulim më të mirë të kthimit në investim për secilën varietet të rrushit;
5. Vendosni strategji të qarta marketingu dhe distribuimi të produktit të përfunduar. Kjo do të ndihmojë në rritjen e kërkesës së produktit dhe në rritjen e kthimit në investim;
6. Përdorni teknologjinë dhe metodat më të mira të kultivimit të rrushit për të përmirësuar produktivitetin dhe koston e prodhimit;
7. Nëse keni vështirësi në identifikimin e varietetit të rrushit dhe planifikimin e prodhimit, konsultohuni me ekspertë të fushës që mund të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë të bëni një zgjedhje të përgjegjshme;
8. Analizoni tregun dhe kërkesën aktuale të rrushit për të identifikuar varietetet e rrushit që janë më të kërkuara dhe mund të ndihmojnë në rritjen e të ardhurave;
9. Konsideroni cilat varietet e rrushit kanë rezistencë të mirë ndaj sëmundjeve dhe kushteve të rënda klimatike. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e shpenzimeve për prodhimin e rrushit dhe do të rrisë prodhimtarinë;
10. Zgjidhni varietetet e rrushit që përshtaten me kushtet klimatike të rajonit tuaj dhe marrni në konsideratë faktorët e tokës dhe mjedisit.

11. Konsultohuni me ekspertë të fushës për të marrë sugjerime në lidhje me këshillat më të mira dhe praktikat e bëra për kultivimin e rrushit dhe mbrojtjen e saj nga sëmundjet dhe kushtet e rënda klimatike;
12. Vlerësoni koston e prodhimit të çdo varieteti të rrushit dhe përcaktoni varietetet që janë më të lira dhe më të shëndetshme për të rritur, dhe me këtë mënyrë përmirësoni rentabilitetin e prodhimit tuaj;
13. Krijojini kontakte dhe bashkëpunimi me grupet e fermerëve të tjerë në rajonin tuaj për të ndarë eksperiencat dhe njohuritë në lidhje me kultivimin e rrushit, dhe të përfitojnë nga praktikat më të mira në lidhje me rritjen e produktivitetit dhe rentabilitetit të prodhimit të rrushit;
14. Rekomandohet që të kenë përkrahje edhe më të madhe financiare për prodhuesit vendorë nga institucionet shtetërore;

Duke u bazuar në hulumtimin e realizuar dhe sipas përfundimeve të nxjerr mund të japim disa rekomandime drejtuar institucioneve të vendit, prodhuesve si dhe konsumatorëve tanë:

- 1) Të rritet personeli mbikëqyrës që të arrihet një siguri sa më e lartë e produkteve ushqimore të pranishme në vendin tonë. Si dhe të kenë një bashkëpunim sa më të mirë në mes institucioneve relevante dhe konsumatorëve tanë që do përmirësonte sigurinë tek produktet ushqimore, si dhe do të rritej besimi i konsumatorëve në produktet vendore, në rastin tonë rritjen e besimit dhe konsumit të rrushit vendore, duke u paramenduar një logjike shumë e thjeshtë, konsumimi i rrushit dhe produkteve vendore do të thotë që paratë të mbesin në vend dhe të qarkullojnë në tregun tonë, tregun e Kosovës, qarkullimi i parave në vend do të thotë rritje dhe zhvillim të ekonomisë së vendit tonë Kosovës;
- 2) Prodhuesit vendor duhet që në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë cilësinë e produkteve dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese, duke ndjekur trajnime dhe duke u konsultuar me ekspert të fushave përkatëse në mënyrë që të kenë sukses më të madh në prodhimtari dhe produkte sa më cilësore për të mbuluar mungesën e tregut me produkte vendore;
- 3) Të bëjnë reklamacione të ndryshme, po ashtu dhe të organizojnë kampanja të ndryshme për rritjen e njohurive tek konsumatorët rreth produkteve vendore, në mënyrë që konsumatorët

tanë të kenë besim dhe të jenë të kënaqur me prodhimet vendore, si dhe ti kenë ato zgjedhje primare në raport me produktet e importuara.

- 4) Konsumatorët rekomandohet të hulumtojnë dhe të mësojnë më tepër rreth produkteve vendore, në mënyrë që të ndryshoj qasja në raport me produktet tona. Në këtë mënyrë do të rritej besimi në produktet vendore, ku do të rritej edhe më shumë interesimi për ti zgjedhur ato para produkteve të importuara.

KAPITULLI 6

Literatura e përdorur:

- Ahmet M. Sulo H. Dhori K. Stefan Q. (2000). *Hyrje ne Ekonomi*. Tirane: Shtepia botuese PEGI.
<https://nexhatqehaja.files.wordpress.com/2018/02/hyrje-nc3ab-ekonomi.pdf>
- Coursera. (2016). *Allocative-vs-productive-efficiency-pareto-optimality-consumer-and-producer*. Gjetur 04 20, 2016, nga <https://www.coursera.org>: <https://.coursera.org/learn/principles-of-microeconomics/lecture/9GjvM/allocative-vs-productive-efficiency-pareto-optimality-consumer-and-producer>
- Dimo A. Rostisa B., Krum H. (2017). *Analiza e shpërndarjes së pagesave direkte në bujqësinë bullgare*.https://www.researchgate.net/publication/339181346_The_Rural_Household_Multiple_Indicator_Survey_data_from_13310_farm_households_in_21_countries
- E.Erjavec, M.Rednak, T.Volk, M.Kozar. (2006). *Reforma e CAP dhe rishpërndarja e pagesave direkte në Slloveni*.https://www.researchgate.net/publication/23509574_Income_Situation_of_Agricultural_Households_in_Slovenia_after_EU_Accession_Impacts_of_Different_Direct_Payments_Policy_Options
- EEA. (2020). *Agjencia Evropiane per Mjedis - Sfidat e bujqesise*.<https://www.eea.europa.eu/soer/2020>
- FAO. (2019). *Food and Agriculture Policy Classification*.<https://www.fao.org/3/ca5162en/ca5162en.pdf>
- FAO. (2020). *Eksplorimi i shkëputjes së pagesave direkte për fermerët në Maqedoninë e Veriut*.
<https://www.fao.org/policy-support/tools-and-publications/resources-details/zh/c/1314659/>
- H.Storm, K.Mittenzwei, Th.Heckelei. (2015). *Pagesat direkte, konkurrenca hapësinore dhe mbijetesa e fermave në Norvegji*.<https://puntoanadero.cl/imagenes/upload/5cd9bc8ae1a33.pdf>
- IFG. (2020). *Politika e Përbashkët Bujqësore*.<https://www.instituteforgovernment.org.uk/article/explainer/common-agricultural-policy>
- Investopedia. (2016). *Economies of scale*. Gjetur 04 10, 2016, nga <http://www.investopedia.com/>:
<http://www.investopedia.com/terms/e/economiesofscale.asp>
- investopedia. (2016). *Is it better for a company to have fixed or variable costs?* Gjetur 04 25, 2016, nga

- <http://www.investopedia.com/http://www.investopedia.com/ask/answers/033015/it-better-company-have-fixed-or-variable-costs.asp>
- Investopedia. (a.d.). *Fixed Cost*. Gjetur 02 01, 2016, nga <http://www.investopedia.com/http://www.investopedia.com/terms/f/fixedcost.asp>
- J.Kozakova, M.Urbanova. (2018). *A ËSHTË I PËRSHTATSHËM SISTEMI AKTUAL I PAGESAVE DIREKTE PËR FERMERËT NË SLOVAKI?*
https://www.researchgate.net/publication/328581984_Is_current_system_of_direct_payments_suitable_for_farmers_in_Slovakia
- Jones, R. (2016). *Production and Cost Analysis*. Gjetur 04 08, 2016, nga <http://slideplayer.comhttp://slideplayer.com/slide/9646815/>
- JRC. (2016). *Analizë e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural të vendeve të Ballkanit Perëndimor*.<https://ideas.repec.org/p/ipt/iptwpa/jrc101320.html>
- Kastner International dhe AVI. (2012).<https://doi.org/10.2514/2.1541>
- Keeney, R. (2014). *Fundi i epokës së pagesave direkte në politikën e fermave të SHBA*.
<https://portal.nifa.usda.gov/web/crisprojectpages/0219669-farm-household-economic-analysis-of-us-farm-conservation-and-energy-policies.html>
- Komisioni Evropian . (2020). *Qëllimet e politikës së përbashkët bujqësore*.https://commission.europa.eu/index_en
- Komisioni Evropian. (2013). *Pasqyrë e Reformës së CAP 2014-2020*.
<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/60185348-1646-11ea-8c1f-01aa75ed71a1>
- Lota D. Tamini, Maurice Doyon, Micheline M.Zan. (2014). *Investment Behavior of Canadian Egg Producers: Analyzing the Impacts of Risk Aversion and Variability of Prices and Costs of Production*. Center for Research on the economics.
https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2388243
- M. Keeney, A, Matthews, J.Frawley. (1997). *Shpërndarja e drejtpërdrejtë në bujqësinë Irlandeze*.
- M.B.P.ZH.R. (2015). *Raporti i Gjelber*. Prishtine: <https://www.mbpzhr-ks.net>
- MBPZHR. (2021). *Vreshtaria dhe Vertaria e Kosovës*: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Vreshtaria_dhe_veretaria_e_Kosovesr.pdf
- M.Brady, J.Hristov, S.Hojgard. (2017). *Ndikimet e pagesave direkte, Mësime për CAP pas 2020 nga analiza sasiore*.https://www.cec.lu.se/sv/sites/cec.lu.se.se/files/agrifood_rapport_20172_impacts_direct_payments.pdf
- MBPZHR. (2017). <https://www.mbpzhr-ks.net/>.

- MBPZHR. (2021). *Programi per Pagesa Direkte per vitin 2021*. <https://www.mbpzhr-ks.net/>.
- motion, F. i. (a.d.). *Financimi bujqesore ne Kosove*. Gjetur 03 05, 2016, nga [http://www.efse.lu/http://www.efse.lu/uploads/tx_neës/Financimi Bujqesor ne Kosove.pdf](http://www.efse.lu/http://www.efse.lu/uploads/tx_neës/Financimi_Bujqesor_ne_Kosove.pdf)
- N.Benni, S.Mann, B.Lehmann. (2011). *Efektet e shpërndarjes së pagesave direkte në Zvicër*. https://agricecon.agriculturejournals.cz/artkey/age-201211-0001_the-distributional-effects-of-agricultural-policy-reforms-in-switzerland.php
- OECD. (2020). *Agricultural policy*. OECD.
- OECD. (2020). *Politika më të mira për të përmirësuar performancën mjedisore të sektorit të bujqësisë*.
- OECD. (2020). *Politika më të mira për të përmirësuar performancën mjedisore të sektorit të bujqësisë*.
- Olumide, A. S. (a.d.). *Academia*. Gjetur 03 02, 2016, nga [www.academia.eduhttps://www.academia.edu/2762668/Temperature and Relative Humidity effects on Egg Production](https://www.academia.edu/2762668/Temperature_and_Relative_Humidity_effects_on_Egg_Production)
- Osmani J. (2003). *Venbanimet e Kosoves, Vushtrria* 16. https://books.google.com/books/about/Vendbanimet_e_Kosoves.html?id=0XOQmwEACAAJ
- P.Boulanger. (2011). *Shpërndarja e pagesave direkte bujqësore: rasti i Francës*. [https://www.google.com/books/edition/Evaluation of Agricultural Policy Reform/yKLqrezhTN4C?hl=en&gbpv=1&dq=P.Boulanger.\(2011\).+Distribution+of+agricultural+direct+payments+the+case+of+france&pg=PA145&printsec=frontcover](https://www.google.com/books/edition/Evaluation_of_Agricultural_Policy_Reform/yKLqrezhTN4C?hl=en&gbpv=1&dq=P.Boulanger.(2011).+Distribution+of+agricultural+direct+payments+the+case+of+france&pg=PA145&printsec=frontcover)
- Pettinger, T. (2012, 11 28). *Allocative Efficiency*. Gjetur 04 20, 2016, nga <http://www.economicshelp.orghttp://www.economicshelp.org> Pillana, M. (2013). *Kalkulimet*. Prishine.
- Prishtine, A. G. (a.d.). *pristina.diplo.de*. Gjetur 03 03, 2016, nga http://www.pristina.diplo.dehttp://www.pristina.diplo.de/Vertretung/pristina/sq/05/01_20_ëirtschaft/01-ëi_20Uebersicht/ëirtschafts_C3_BCbersicht_20Kosovo.html
- R.Dziemianoëicz, R.Przygodzka, A.Sadoëski. (2008). *Pagesat direkte dhe ndikimi i tyre në tregun e tokës në Poloni*.
- Recica, F. (2009). *aab-edu*. Gjetur 03 05, 2016, nga aab-edu.net: https://aab-edu.net/doënloads/01_2009_04_fet_UJux.pdf
- Riinvest, I. (2004). *ZHVILLIMI RURAL NË KOSOVË*. Prishtine: Instituti Riinvest. Gjetur 03 04, 2016, nga <http://www.riinvestinstitute.org/>.

Stefan Bojnec, L. L. (2012). Farm size, agricultural subsidies and farm performance in Slovenia. *ELSEVIER*.

https://www.researchgate.net/publication/271636767_Farm_size_agricultural_subsidies_and_farm_performance_in_Slovenia

T.Roe, A.Somwaru, X.Diao. (2002). *A kanë efekte ndërkohore pagesat direkte në bujqësinë e SHBA-së?* <https://www.jstor.org/stable/3877186>

Tamsin Cooper, Kaley Hart, David Baldock . (2009). *Provision of Public Goods through Agriculture in the European Union*. London.

https://ieep.eu/wp-content/uploads/2010/01/final_pg_report.pdf